Hyrje: Geriatria është shkenca mjekësore që merret me parandalimin, mjekimin dhe rikuperimin e gjendjeve morboze gjatë plakjes. Fakti që kjo popullatë, 65+, po rritet edhe tek ne, në 15,2% në vitin 2021 krahasuar me 11% në vitin 2011, kërkon një vëmëndje më të fokusuar rrëth shërbimit shëndetsor dhe social të veçantë që kjo fashë moshe kërkon. Problemet kryesore të saj kanë të bëjnë me ; ruajtjen e shëndetit që nënkupton edukimin shëndetsor e vaksinimin e të moshuarit, diagnostikimin e hershëm të sëmundjes, parandalimin e humbjes së autosuficiencës , mbikqyrjen e vazhdueshme të atyre që janë me rrezik të lartë , mjekimin bashkëkohor dhe rikuperimin e mundshshëm. Rreth 60% e të moshuarve vuajnë me sëmundje kronike

Objektivat: Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i problematikave të shërbimit shëndetsor në Durrës dhe rekomandimin e masave si në aspektin e formimit të personelit mjekësor ashtu edhe në krijimin e strukturave bashkëkohore të afta për t'i dhënë përgjigje efikase nevojave të shoqerisë sonë me tendencë transformimi radikal.

Metoda: Ky është një studim hulumtues profesional rrëth ligjeve, programeve mësimore universitare dhe pas universitare, strukturave shëndetsore, programeve qeveritare dhe shtrimet në spital të lidhura me fashën e moshës 65+.

Rezultatet: Nga hulumtimet e kryera për dokumentacionet në lidhje me shërbimin shëndetsor ndaj të moshuarit rezultoi se ekzistojnë disa masa konkrete si; vizitat në institucionet shtetërore dhe disa medikamente falas, shtrimet në spitalet shtetërore jo të specializuara për të moshuar falas, futja në check up edhe të një pjese të moshuarish (65-70 vjeç), mbështetje e pjesshme e protezimeve sidomos ato kockore, mbështetje e pjesshme me vaksina antigripale sezionale. Ekzistenza e një qendre ditore për të moshuar me 4 asistente sociale dhe një infermiere jo e specializuar. Shtrimet në repartin e patologjisë në SRD nga 1 Janari 2022 – 1Mars 2022, ishin 210 pacientë, nga të cilët 137 ishin të moshës 60+, që përbëjnë rrëth 65,2% të shtrimeve, me një predonim të gjinisë

mashkullore me 42%. Numri i shtretërve në shtëpi të të moshuarve rezultoi 0.

Konkluzionet: Në Bashkinë Durrës shërbimi shëndetsor për të moshuarit paraqet problematika mjافت të mëdha. Vizitat kryhen nga mjeku i familjes të patrajnuar në geriatri, në shumicën e rasteve vetëm në qendrën shëndetsore duke mos afruar shërbim për ata të brishtë ose disabël. Nuk mbulohen me check up të gjithë të moshuarit. Masat parandaluese si vaksinat, edukimi shëndetsor, zbulimi hershëm, ruajtja e autosuficiencës dhe ndjekja e grupeve me rrisk të lartë janë sporadike, pa planifikim dhe jo gjithë përfshirëse. Personeli shëndetsor sidomos mjek si në shërbimin ambulator dhe atë spitalor por edhe në qendrën ditore të pleqve ka njojuri të fakta për gerontologjinë si pasojë e mungesës së njojurive universitare dhe pas universitare. Mungojnë qendrat e mirëfillta për vlerësimin shumëdimensional të të moshuarve. Mungojnë shtëpitë dhe repartet për trajtimin e të moshuarve.

Fjalë kyç: Shërbim shëndetsor, i moshuar, geriatri, Durrës.

Menaxhimi i Traumave okulare



Dr. Marsida Krasniqi¹

¹ Department of Medical Sciences, University Aleksander Moisiu, Durres, Our Lady of Good Counsel, Tirana.

Abstrakt

Dëmtimet okulare janë të zakonshme në departamentin e emergjencave dhe ato janë shkaku më i shpeshtë i verbimit monokular tek fëmijët dhe të rriturit. Menaxhimi i pacientëve me trauma okulare mund të trajtohet plotësisht nga mjeku i familjes. Ndihma e parë është e rëndësishme dhe efektive pasi mund të parandalojë komplikimet, të cilat mund të çojnë në përkeqësimin e mëvonshëm të syrit. Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë rekomandime të bazuara në raste klinike, të ofrojë parimet e menaxhimit, komplikimet dhe prognozën e pacientit me traume okulare. Ky studim do të fokusohet në konceptin e riparimit traumatik të globit të traumatizuar dhe gjithashtu do të japë udhëzime rreth planifikimit strategjik në menaxhimin e traumave okulare. Në këtë studim jane mbledhur pacientë të ndryshëm të paraqitur në klinikën tonë me dëmtime okulare. Në studimin ne i ndamë pacientët sipas llojit të dëmtimit: pacientët me dëmtim të hapur të globit fig. 1; Pacientët me dëmtim të mbyllur të globit fig.2; pacientët me plagë shpuese fig. 3; pacientët me trup të huaj intraokulare fig.4; pacientët me djegie kimike fig.5; pacientët me efektet e rezatimit; pacientët me trauma orbitale dhe adnexale fig.6. Në bazë të llojit të dëmtimit okular ne do të japim rekomandimet për menaxhimin e dhimbjes, përdorimit te antibiotikëve, cikloplegjiket, steroideve dhe mbylljes okulare. Komplikimi i traumës okulare do të jetë pjesë e këtij studimi ku diagnoza e hemorragjisë retrobulbar do të diskutohet në hollësi. Si përfundim mund të themi se është e rëndësishme diagnostikimi i hershëm dhe menaxhimi i pacientëve për të siguruar mundesine më të mirë për një rezultat të favorshëm vizual. Një ndjekje sistematike e pacientëve me traumë okulare duhet të bëhet për të parandaluar komplikacionin post-traumatik.

Fjalët kyçë: trauma okulare, menaxhimi, llojet e ndryshme



Shërbimi dentar gjatë pandemisë COVID-19 (SARSCoV2)

Dr. Enis URUCI¹
MD. Emirjeta KUNIQI²

^{1,2} Departamenti i shkencave teknike mjekësore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
emirjetakuniqi@gmail.com
enisuruci@gmail.com

Abstrakt

Qëllimi dhe objektivat: Punimi yne eshte një rishikim literature e synon të ofrojë një përbledhje të pandemisë së sëmundjes së koronavirusit-2019 (COVID-19) ne këndvështrimin dentar. Paraqet standarde dhe udhëzimet e ofrimit të kujdesit dentar bazuar në kërkimet e disponueshme në këtë fushë, si dhe përvojën dhe praktikën klinike.

Hyrje: Pandemia aktuale e COVID-19 e shkaktuar nga sindroma e rëndë akute e frymëmarjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2) po përhapet në mbarë globin dhe ndërhyn në ofrimin e kujdesit dentar për shumë individë nga komunitete dhe prejardhje të ndryshme.

Metoda: U krye një kërkim për literaturën mbi PubMed, ISI Web of Science, Scopus, EMBASE dhe Bibliotekën Cochrane nga 1 Mars 2020 deri më 30 Janar 2022. Gjithashtu, bibliografitë e përfshira në artikujt e treguar u përdorën për të identifikuar literaturë të mëtejshme. U konsultuan gjithashtu rekomandimet e autoriteteve shëndetësore në vende të ndryshme.

Rezultatet: COVID-19 po shkakton shumë vdekje dhe po prish jetën e përditshme të njerëzve dhe ekonominë në shumë vende të botës. Për shkak të potencialit të infeksionit të kryqëzuar përmes trajtimeve dentare, veçanërisht procedurave të gjenerimit të aerosoleve dentare, sherbimi stomatologjik u ndërpren gjatë periudhes Mars-Qershori 2020. Ofrimi i kujdesit dentar është ndërpërë plotësisht ose pjesërisht (i kufizuar në trajtim urgjent ose urgjent) në shumicën e vendeve të botës. Sherbimi dentar u ofrua vetem ne Qendra Kombetare Stomatologjike Universitare vetem per raste urgjente. Mandej sherbimi stomatologjik rifilloi aktivitetin e tij duke zbatuar protokollet e masave te parandalimit te perhapjes te infeksiobit SARS-CoV-2

Përfundime: Kërkohen udhëzime dhe standarde për trajtimin dentar në mes të pandemisë COVID-19. Ky dorëshkrim ofron një përbledhje të pandemisë COVID-19 nga këndvështrimi dentar standarde dhe udhëzime te ofrimit të kujdesit dentar bazuar në kërkimet e disponueshme në këtë fushë, si dhe përvojën dhe praktikën klinike.

Fjalë kyçe: Aerogene, COVID-19, Sherbim dentar, masat parandaluese, transmetimi viral SARS-CoV-2

Efikasiteti i Teknikës Mulligan në konfliktin subacromial (Rishikim literature)

Selda Veizaj¹
Jonida Drizaj³

¹Lektore në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës.

²Fizioterapiste në klinikën Physiola, Tiranë

³Lektore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

seldaveizaj@gmail.com

Abstrakt

Të dhëna të përgjithshme: Konflikti subacromial është një patologji e lokalizuar në artikulacionin gleno-humeral, që shfaqet si pasojë e komprimimit të indeve të buta dhe bursës. Koncepti i Mulligan bazohet në biomekanikën dhe konceptet anatomike të trupit të njeriut.

Qëllimi: Vlerësimi i efektit të teknikës Mulligan në konfliktin subacromial.

Metodologjia: Studimi është rishikim literature. Të dhënat u grumbulluan duke vëzhguar 6 site elektronike dhe revista shkencore. Studime të randomizuara u përfshin në studimin tonë. Testet ndërkombe të përdorura në studimet e përfshira në studimin tonë janë: shkalla vizuale e dhimbjes, disfunksioni i krahut, shpatulle dhe dorë, forma 36 e shkurtuar, dhimbja actuale, shkalla numerike, goniometër, pikëzimi constant i shpatullës.

Rezultatet: Nga 65 studime të gjetuara nga fjalët kyçë, vetëm 6 plotësuan kriteret tona. Studimi i Yanwu Wang pati pikëzimin maximal sipas shkallës Pedro, i pikëzuar me 9 pikë.

Conkluzioni: Teknika Mulligan rezultoi efektive për rehabilitimin e konfliktit subacromial.

Fjalët kyçë: Konflikti Sub-acromial, Koncepti Mulligan, terapia manuale.

Ndikimi i profilit të fytyrës në posturën dhe ekulibrin

Selda Sokoli Veizaj¹
Dr. Rezarta Kalaja²,
Aida Lako³,
Ledjona Myrtaj⁴

^{1,2,3}Lekture, në Universitetin Aleksandër Moisiu, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Durrës

⁴Lekture, në Universitetin e Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë

* seldaveizaj@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Pjesmarrësit në studimin tonë u vlerësuan duke u fotografuar sipas planit sagital, ku është përcaktuar tipi i profilit të fytyrës. Qëllimi i studimit është vlerësimi i profileve të fytyrës dhe identifikimi i një lidhje midis posturës dhe ekulibrit në statik dhe dinamik.

Metoda: Ky është një studim pilot i zhvilluar në muajin dhjetor 2021. Në laboratorin e Fizioterapisë në UAMD. Me një numër pjesmarrësishprej N = 7, testet e aplikuara gjatë studimit ishte testi Romberg dhe Tandem.

Rezultatet: Në studimin tonë 57.3% e Pacientit i përkasin porfilit të fytyrës ortognatik, më pas kemi praninë e profilin e fytyrë retrognatik then we have the Retrognatic profile. Pavarsisht tipit të profilit të fytyrës Pacientët kanë një pikëzim më të vogël në testit dinamik në krahasim me testin static. Profili i fytyrës ortognatike karakterizohet nga një ekilibër I mire në static dhe në dinamik.

Konkluzione: Vërejmë një ndërlidhje midis profilit të fytyrës dhe ekulibrit të pjesmarrësve. Profili i fytyrës ortognatik konsiderohet si profili me ekilibër më të mire në statik dhe dinamik dhe pikëzohen më shumë se profilet e tjera.

Fjalët kyçë: Profili i fytyrës, problemet e ATM, anomalitete të fshehura, ekilibri në statik dhe dinamik.

**Hemiplegjia, Riaftësimi dhe Rehabilitimi i saj gjatë
Periudhës 2009-2019 në Qëndrën Spitalore Universitare
“Nënë Tereza” Tiranë.**

Dr. Aida Lako¹
Msc.Selda Veizaj²
Prof. Asoc Irena Kola³

^{1,2}*Lektore, në Universitetin Aleksandër Moisiu, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Durrës*

Abstrakt

Hyrja: Rëndësia e protokollit të trajtimit dhe shkallëve të vlerësimit për pacientët që vuajnë nga hemiplegia në Shqipëri.

Objektivat e studimit: Objektiva kryesore e këtij studim është krijimi i protokolleve të trajtimit rehabilitues dhe shkallëve të vlerësimit për pacientët që vuajnë nga hemiplegja. Pra, ne si fizioterapistë të kemi mundësinë të zgjedhim një metode rehabilitimi apo një metode tjeter, për të arritur integrimin e pacientit në ADL.

Materiali dhe Metoda: Studimi është kryer gjatë periudhës kohore 2009-2019 dhe këto të dhënat janë nxjerrë nga kartelat klinike të pacientëve në Institutin e Shëndetit Publik Tiranë. Gjithsej janë 379 pacientë që rezultuan me hemiplegji. Të dhënat u analizuan dhe u nxorën përfundime përmes programit Megastat. Vlera $p<0.05$ u konsiderua statistikisht e rëndësishme.

Rezultatet: Nga 379 pacientë të përfshirë në studimin e dhënë na rezultoi se grupmosha më e prekur është 60-80 vjeç. Ka një mbizotërim të meshkujve 222(51%) krahasuar me femrat 157(49%) me hemiplegji. Hemiplegja dex 203 (53,56%), Hemiplegja sin 176(46,44%) raste. Rastet me hemiplegji që janë rehabilituar janë 239 (52%). Vetëm 17% e pacientëve janë përmirësuar nga rehabilitimi me hemiplegji dhe rastet që nuk janë rehabilituar nga 379 raste janë 219 (48%). Në 3 testet e Analizës së Regresionit në lidhje me hipotezat tona për grupmoshat, zbuluam një ndryshim statistikisht domethënës($p<0.05$) dhe në këtë mënyrë ato mund ti përdorim mesatarisht për të ardhmen.

Konkluzione: Vendi ynë ka nevojë urgjente për vendosjen e një protokolli të standardizuar rehabilitimi, shkallëve të vlerësimit dhe aplikimin e tyre. Në këtë mënyrë jo vetëm që ndihmon në reduktimin e aftësisë së kufizuar, por rrjedhimisht edhe në uljen e depresionit të pacientëve, pasi ata arrijnë të bëhen më autonom. Në këtë mënyrë do të kemi përfitime socio-ekonomike për vendin tonë, sepse hemiplegja sjell një paaftësi të madhe për këta pacientë.

Fjalët kyçe: Paraliza e shkaktuar nga dëmtimet cerebrale, hemiplegia, menaxhimi fizioterapeutik, hemiplegia, terapia fizike.

Shërbimi infermieror në repartin e terapisë intensive për infarktin akut të miokardit

Dr. Violeta Zanaj¹
Klementina Vogli²

¹Lekture në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës.

Abstrakt

Hyrja: Infarkti i miokardit është një sëmundje kërcënuese për jetën që ndikon në dimensionet fizike, psikologjike dhe sociale të individit. Mënyra e gabuar e jetesës është një nga shkaqet e kësaj sëmundje. Hartimi dhe implementimi i protokollit të ndërhyrjeve infermierore për pacientët me Infarkt Akut të Miokardit mund të jetë një nga hapat e rëndësishëm dhe thelbësor në përmirësimin e rezultateve të pacientëve me Infarkt të Miokardit. Modeli i kujdesit në Njësisë Koronare ka ndryshuar, lirimi i hershëm nga spitali është një kërkesë e rëndësishme. Hulumtimi ka treguar se menaxhimi i pacientëve me infarkt akut të miokardit, duke aplikuar procedurat sipas procesit infermieror, kontribuon shumë që pacientët të mundë të përballen me problemet gjatë fazës akute të sëmundjes dhe në të ardhmen pacientët janë në gjendje të përballojnë masat që duhet të ndërmarrin për të rregulluar mënyrën e jetesës së tyre.

Qellimi i studimit: Studimi ka treguar se kujdesi infermieror, për pacientët me infarkt akut të miokardit, është tejet i rëndësishëm si në menaxhimin terapeutik dhe në monitorimin e shenjave vitale, po ashtu edhe në edukimin e pacientëve dhe familjarëve të tyre lidhur me vazhdimin e trajtimit gjatë dhe pas daljes nga spitali.

Materiali dhe metoda: Ky studim rasti synon që nëpërmes të një studim rasti të prezantohen karakteristikat e procesit infermieror te pacientët me infarkt akut të miokardit. Kujdesi infermieror për këtë pacient filloj me historinë e sëmundjes dhe ekzaminimin fizik. Ky vlerësim ishte i nevojshëm për të hartuar një plan të kujdesit infermieror. Në këtë studim është parë se roli i infermierëve është posaçërisht i rëndësishëm në menaxhimin e dhimbjes dhe largimin e ankthit tek pacientët me infarkt akut të miokardit.

Konkluzione: Nga ky studim rasti ne rekomandojmë që mënyra e aplikimit të procesit infermieror nga ky studim, mund të përdoren në praktikën infermierore në sektorët e kujdesit shëndetësor për tu ofruar trajtim të duhur pacientëve me infarkt akut të miokardit dhe gjithashtu mund të shërbej për edukim në kujdesin shëndetësor.

Fjalët Kyçe: Infarkti Akut i Miokardit, Procesi Infermieror, Kujdesi Infermieror.

Manifestimet Orale të pacientëve COVID-19: Rishikim Sistematik

Orion Muçaj¹
Anri Troja²

¹Departamenti i Mjekësisë, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Universiteti

Aleksandër Moisiu, Durrës, Albania,

²Rezident Anestezi QSUT Tiranë

Abstrakt

Hyrje: SARS-CoV-2 është një virus ARN i mbështjellë, me sens pozitiv, me një zinxhir, me thumba të shumta në sipërfaqe dhe një madhësi gjenomi prej afërsisht 26-32 kilobaze. Simptomat kryesore të shfaqura gjatë fazës para-simptomatike janë ageuzia (humbja e shijes), anosmia jo specifike (humbja e nuhatjes) dhe hiposalivimi. Shenjat orale më të shpeshta të raportuara përfshijnë lezione ulcerative, lezione vezikulobuloze/makulare, gingivit deskuamativ, peteki dhe koinfeksione të tilla si kandidiaza. Piklat e fryshtës së origjinë nga hunda, kaviteti oral dhe rrugët e fryshtës së origjinë nga rrugët kryesore të transmetimit të SARS-CoV-2 dhe pështyma është një nga burimet më të rëndësishme të piklave. Nivelet e rritura të citokinave proinflamatore si IL-1 dhe TNF të zbuluara në gingivën e inflamuar në COVID-19 mund të konfirmojnë gjendjen inflamatore lokale. Të kuptuarit e manifestimeve dhe progresionit të COVID-19 është hapi i parë në zhvillimin e një menaxhimi adekuat të parandalimit dhe trajtimit.

Objektivat: Objektivi i këtij rishikimi sistematik ishte të siguronte një përbledhje gjithëpërfshirëse të përditësuar të prevalencës së manifestimeve orale në pacientët e shtruar në spital me COVID-19, duke rishikuar të gjitha studimet përkatëse për t'i përgjigjur pyetjes së mëposhtme: Cilat janë shenjat dhe simptomat teorike në spital per pacientët me COVID-19? Ky rishikim sistematik mund t'i ndihmojë mjekët të përqendrohen në ekzaminimin e detajuar intraoral të pacientëve të shtruar në spital përpara dhe gjatë shtrimit të tyre.

Materialet dhe metodat: Literaturë e huaj, në librari dhe database ndërkombëtarë.

Konkluzione: Bazuar në këtë rishikim sistematik, mund të sugjerohet se: (1) ulcerat e dhimbshme orale, cheilitis dhe lezionet e gjuhës janë më të shpeshta te pacientët përpara shtrimit në spital; (2) ulcerat e presionit perioral, makroglosia, flluska dhe kandidiaza orale janë më të dukshme pacientët gjatë shtrimit në spital; (3) lezionet që u shfaqën përpara shtrimit në spital lidhen kryesisht drejtëpërdrejt me COVID-19; (4) lezionet që u shfaqën gjatë shtrimit në spital shoqërohen kryesisht me pajisje dhe trajtime mjekësore, pozicion të prirur dhe dëmtim imunologjik; (5) të gjithë klinicistët, gjatë shtrimit në spital, duhet të

inkurajohen të kryejnë një ekzaminim të saktë oral të të gjitha rasteve të konfirmuara të COVID-19 për të njojur manifestimet e hershme të mundshme të sëmundjes; (6) Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të përcaktuar rëndësinë patologjike të manifestimeve orale gjatë COVID-19.

Fjalët kyçe: COVID-19, saliva, leziona të gjuhës, leziona vezikulobuloze, eritemë, stomatit.

Referenca

1. Chen, N.; Zhou, M.; Dong, X.; Qu, J.; Gong, F.; Han, Y.; Qiu, Y.; Wang, J.; Liu, Y.; Wei, Y.; et al. Epidemiological and Clinical Characteristics of 99 Cases of 2019 Novel Coronavirus Pneumonia in Wuhan, China: A Descriptive Study. *Lancet* **2020**, 395, 507–513. [\[CrossRef\]](#)
2. Ramires, M.C.C.H.; Mattia, M.B.; Tateno, R.Y.; Palma, L.F.; Campos, L. A Combination of Phototherapy Modalities for Extensive Lip Lesions in a Patient with SARS-CoV-2 Infection. *Photodiagnosis Photodyn. Ther.* **2021**, 33, 102196. [\[CrossRef\]](#)
3. Iranmanesh, B.; Khalili, M.; Amiri, R.; Zartab, H.; Aflatoonian, M. Oral Manifestations of COVID-19 Disease: A Review Article. *Dermatol. Ther.* **2021**, 34, e14578. [\[CrossRef\]](#)
4. Chiotos, K.; Bassiri, H.; Behrens, E.M.; Blatz, A.M.; Chang, J.; Diorio, C.; Fitzgerald, J.C.; Topjian, A.; John, A.R.O. Multisystem Inflammatory Syndrome in Children During the Coronavirus 2019 Pandemic: A Case Series. *J. Pediatr. Infect. Dis. Soc.* **2020**, 9, 393–398. [\[CrossRef\]](#) [\[PubMed\]](#)
5. Marouf, N.; Cai, W.; Said, K.N.; Daas, H.; Diab, H.; Chinta, V.R.; Hssain, A.A.; Nicolau, B.; Sanz, M.; Tamimi, F. Association between Periodontitis and Severity of COVID-19 Infection: A Case-Control Study. *J. Clin. Periodontol.* **2021**, 48, 483–491. [\[CrossRef\]](#)
6. Riestra-Ayora, J.; Yanes-Diaz, J.; Esteban-Sanchez, J.; Vaduva, C.; Molina-Quiros, C.; Larran-Jimenez, A.; Martin-Sanz, E. Longterm follow-up of olfactory and gustatory dysfunction in COVID-19: 6 months case-control study of health workers. *Eur. Arch. Otorhinolaryngol.* **2021**, 278, 4831–4837. [\[CrossRef\]](#)

Covid-19 dhe trajtimi medikamentoz i tij

¹Msc.Tiziana Ceka

²Msc.Eris Nepravishta

^{1,2} Departamenti i shkencave teknike mjekësore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Abstrakt

Hyrje: Covid-19 eshte nje virus nga familjet e koronavirusit (Cov) te cilat shkaktojne patologji si gripi dhe e ftohura e zakonshme,te cilat shfaqen me simptoma te lehta deri tek ato me te rendat.Koronaviruset jane viruse me origjine shtazore dmth vijne nga kafshet madje disa prej tyre transmetohen nga kafshet tek njeriu.Ky virus u shfaq ne dhjetor 2019 ne Wuhan ne Kine dhe me pas u perhap ne gjithe boten duke marre permasat e pandemise. Dexamethason,kortikosteroid jane medikamente qe perdoren per uljen e inflamacionit.Jepet ne pacientet me support respirator,pasi eshte me efektiv. Remdesevir,medicament antivirale qe trajton COVID-19,aktualisht eshte ilaci i vetem qe eshte aprovar nga Administrata e Ushqimit dhe Barnave. Rekomandohet per perdorimin ne pacientet e shtruar ne spital qe kerkojne oksigen shtesë. Antikoagulantet, mjeku pershkruan doza te vogla te Heparines/Enoxaparine per te shmangur formimin e nje trombi te mundeshem si pasoje e mpiksjes se gjakut nga COVID-19. Vitamina D3 1000/3000 UI ne dite.Pamjaftueshermeria e vitamines D3 eshte shoqeruar me nje rrezik ne rritje te marrjes se COVID-19. Vitamina C500 mg (2 here ne dite) njihet per vete anti-inflamatore,anti-oksiduese dhe imunitare. Zinku 30-50 mg/dite frenon ARN-polimerazen e varur nga ARN in vitro kunder SARS-CoV-2 virus.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi eshte evidentimi i rekomandimeve më të fundit ne lidhje me protokolin e trajtimit të COVID-19.

Metodologja: Është studim me natyrë deskriptive mbështetur mbi rishikimin e literaturës në lidhje me protokollet e fundit mbi trajtimin e COVID-19 në databazën e Pubmed.

Konkluzionet: Nevoja për informim dhe trajnimi i stafit mjekësor me protokollet e fundit dhe paisja me mjetet e nevojshme dhe të specializuara sepse rritet numri i komplikacioneve në mos trajtimin adekuat dhe në kohë të këtyre pacientëve.

Fjalë kyce:Covid-19,Protokoll,Trajtim,Medikamentë,Studim.Terapi.

Bio-etika dhe inteligjenca artificiale ne mjekesi. Abstrakt teorik për të ardhmen e qënies njerëzore

Prof. Dr. Andrea GUDHA¹

¹ Departamenti i shkencave teknike mjekësore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Abstrakt

Në shek. 19-20-të, organizmi i njeriut u njoh në nivel organesh dhe në nivel qelizor.

Në fund të shek.20-të dhe në fillim të shek. 21-të kemi fillimin e studimeve shkencore më të thelluara të Projektimit të Organizmit të Njeriut në nivel molekular dhe qelizor (bërthama) ADN.

Bio-etika...

"Ligjet e natyrës"! Problem esencial Bio-etik dhe Social në të ardhmen për racën e shoqërisë njerëzore në përgjithësi dhe për individin në veçanti, si qënie njerëzore. "Njerëzit janë qënie prej mishi dhe gjaku"! Inteligjenca artificiale nuk ka moralin dhe ndjenjat njerëzore...!

Vlera diagnostike dhe prognostike e D-dimer në Covid-19

Dr. Majlinda Kallco¹
Dr. Jorida Zoga²

¹ Departamenti i shkencave teknike mjekësore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Abstrakt

Hyrje: COVID-19 u përhap në mbarë botën që nga dhjetor 2019. Një nga shkaqet vdekjeprurëse të kësaj semundje është edhe tromboembolia pulmonare. Për të vlerësuar parametrat e koagulimit dhe për të menaxhuar ecurinë e kësaj sëmundje që në stadet e hershme një ndër biomarkuesit e përdorur për analiza laboratorike ka qënë matja e D-dimer.

Qëllimi i studimit: Të zbulojë nëse vlerat e larta të D-dimer janë parashikuese të prognozës së keqe të sëmundjes dhe se matja e hershme e D-dimer ndihmon në uljen e mortalitetit nga Covid-19.

Materiali dhe metoda: Në studim u perfshinë 3150 pacientë (mosha 25 – 80 vjeç). Për matjet e D-dimer u perdor aparati Minividas i firmes Biomerieux dhe Sysmex CA 660. Pacientët u ndanë në 3 grupe studimi sipas vlerës së matjes së D – dimer. Grupi i parë D-dimer 0 – 1500 ng/ml, grupi i dytë 1500 – 5000 ng/ml dhe grupi i tretë D-dimer > 5000 ng/ml. Matja e D-dimer të këtyre pacientëve u bë në harkun kohor të 5 ditëve për të parë ecurinë e sëmundjes.

Rezultati: D-dimer është një nga matjet e përdorura në Covid-19 për të parashikuar trombozën. Studimi tregoi se rritja e D-dimer 3-4 herë mbi normë shoqërohet me një prognozë të keqe. Vlera e D-dimer >1500 në ditën e 5 tregon një incidencë më të lartë mortaliteti krahasuar me pacientët me vlerë <1500.

Konkluzioni: D-dimer > 1500 në ditën e 5 të sëmundjes mund t'i ndihmojë klinikistët të identifikojnë që në stade të hershme të Covid-19, pacientët me prognozë më të keqe të sëmundjes.

Fjalë kyçe: COVID-19; D-dimer; mortalitet.

Referenca:

1. Rostami M, Mansouritorghabeh H. D-dimer level in COVID-19 infection: a systematic review. Expert Rev Hematol. 2020 Nov;13(11):1265-1275. doi: 10.1080/17474086.2020.1831383. Epub 2020 Oct 12. PMID: 32997543.
2. Li Y, Zhao K, Wei H, Chen W, Wang W, Jia L, Liu Q, Zhang J, Shan T, Peng Z, Liu Y, Yan X. Dynamic relationship between D-dimer and COVID-19 severity. Br J Haematol. 2020 Jul;190(1): e24-e27. doi: 10.1111/bjh.16811. Epub 2020 Jun 9. PMID: 32420615; PMCID: PMC7276819.

Dermatiti herpetiformis. Rast Klinik.

MD. Emirjeta Kuniqi¹

Dr. Enis Uruci²

^{1,2} Departamenti i shkencave teknike mjekësore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

E-mail:emirjetakuniqi@gmail.com

Email:enisuruci@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Dermatiti herpetiformis (DH) është një sëmundje inflamatore e lëkurës me një ecuri kronike e relapse, lezione polimorfike, kruajtje dhe gjetje tipike histopatologjike dhe imunopatologjike. Më shpesh shfaqet në bërryla, gjunjë, gluteus, në pjesën e poshtme të shpinës dhe në lëkurën e kokës. Mosha më e zakonshme e shfaqjes së DH është 30-40 vjeç, por mund të preken individët e të gjitha moshave. DH është e rrallë tek fëmijët. DH është një manifestim i lëkurës i sëmundjes celiakisë (CD). DH trajtohet me një dietë pa gluten dhe shpesh pergjigjet mirë ndaj mjekimit me diaminodiphenyl sulfone (DDS).

Qëllimi: Qëllimi ynë është të paraqesim eksperiencën tonë në menaxhimin e një fëmije me dermatit herpetiforme, si një entitet i rrallë, të nxjerrim në pah paraqitjet e ndryshme në lëkurë të DH dhe të inkurajojmë mjekët që ta marrin parasysh këtë diagnozë tek pacientët e rinj me sëmundje atipike të lëkurës. Fëmijët me DH paraqiten në mënyrë të ngashme me të rriturit; megjithatë, janë raportuar gjetje të pazakonta të lëkurës. Për shkak të rritjes së rrezikut për sëmundje autoimune dhe limfoma, diagnoza dhe trajtimi i saktë janë të domosdoshme.

Metoda: U kryen ekzaminimet klinike, laboratorike, serologjike, imunohistokimike dhe radiologjike.

Rezultate: Në këtë abstrakt prezantojmë një rast të DH në një djalë 10-vjeçar që paraqitet tek mjeku me lezione e kruajtje të lëkurës, të vërtetuarë më pas si dermatitis herpetiformis (DH) si shenja e parë e sëmundjes së intolerances ndaj glutenit. Shenjat klinike herë pas here rëndohen ose lehtësohen, por së fundmi i janë shtuar dhimbja e këmbëve, anoreksi, prapambetje në peshë e gjatësi ($P=30$ kg, gjatësia=130cm). Pacienti iu nënshtrua ekzaminimeve laboratorike, serologjike, biopsy, histologji, të cilat konkluduan në Dg. Dermatitis herpetiformis.

Konkluzione: Dermatiti herpetiformis është patologjia më e zakonshme shoqëruese e CD, edhe pse e rrallë në foshnjëri, ajo duhet të merret parasysh në çdo fëmijë që paraqet prapambetje të rritjes dhe zhvillimit, skuqje atipike kronike që nuk i përgjigjet masave të thjeshta.

Fëmijët me DH paraqiten në mënyrë të ngjashme me të rriturit; megjithatë, janë raportuar gjetje të pazakonta të lëkurës. Për shkak të rritjes së rezikut për sëmundje autoimune dhe limfoma, diagnoza dhe trajtimi i saktë janë të domosdoshme.

Fjalë kyçe: sëmundje celiakisë (CD), prurit, ndjeshmëri ndaj glutenit, sëmundje kronike autoimmune, dermatit herpetiformis.

Referenca:

1. Salmi TT. Dermatitis herpetiformis. Clin Exp Dermatol. 2019 Oct;44(7):728-731. doi: 10.1111/ced.13992. Epub 2019 May 15. PMID: 31093998.
2. Nguyen CN, Kim SJ. Dermatitis Herpetiformis: An Update on Diagnosis, Disease Monitoring, and Management. Medicina (Kaunas). 2021 Aug 20;57(8):843. doi: 10.3390/medicina57080843. PMID: 34441049; PMCID: PMC8400185.
3. Kauppi S, Jokelainen J, Timonen M, Tasanen K, Huilaja L. Atopic Dermatitis Is Associated with Dermatitis Herpetiformis and Celiac Disease in Children. J Invest Dermatol. 2021 Jan;141(1):191-193.e2. doi: 10.1016/j.jid.2020.05.091. Epub 2020 Jun 12. PMID: 32540248.

Përdorimi i AIJS-ve gjatë pandemisë Covid-19 (Artikull Rishikues)

Msc. Eris Nepravishta¹

MD. Ervin Nepravishta²

Msc. Tiziana Ceka³

^{1,3} Departamenti i shkencave teknike mjekësore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

² Spitali Universitar i Traumës, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Siç besohet gjerësisht, përdorimi i barnave Antiinflamatore jo steroide (AIJS) në Sindromën Akute të Distresit Respirator të shkaktuar nga Covid-19 nuk është inkurajuar, dhe kjo për arsyen e frikës që ekziston në efektet që mund të kenë në shtimin e rrezikut të infektimit dhe/ose përkeqësimin e symptomave.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është paraqitja e studimeve dhe literaturave të ndryshme globale nëlidhje me përdorimin e AIJS në rastet me Covid-19.

Materiale dhe Metoda: Që nga shfaqja e pandemisë Covid-19, lidhur me numrin e lartë të raportimeve të vazhdueshme subjektive të efekteve anësore të përdorimit të AIJS në pacientët e Covid-19, janë botuar mbi 200 artikuj shkencor për të hetuar çdo lidhje të mundshme midis përdorimit të zakonshëm të AIJS dhe Covid-19. Këta artikuj përfshijnë, si rastet që kanë përdorur AIJS para shfaqjes së pandemisë, por edhe përdorimin e vetë AIJS në trajtimin dhe qoftë edhe përmirësimin e symptomave të infeksionit. Të gjitha studimet e tematikës në fjalë, që ofrojnë informacion në lidhje me rezultatet e ekspozimit të infeksionit të Covid-19 me AIJS, janë përfshirë dhe grupuar në përbledhjen sistematike rishikuese botuar për herë të parë në 2 Gusht 2021 në librarinë kombëtare të mjekësisë të SHBA, në pritje të një përditësimi kontribues në 21 mars 2022.

Konkluzione: Si konkluzion përdorimi i AIJS në pacientët me Covid-19 nuk shoqërohet me asnjë risk: në infektimin apo shtimin e testimit pozitiv për sindromën akute respiratore të Covid-19; në shtimin e shtrimeve në spital për komplikacionet e Covid-19 apo në përkeqësimin e symptomave dhe/apo vdekjen, si pasojë e Covid-19. Këto të dhëna me forcën e mjaftueshme të besueshmërisë përfshirë përfshirë çdo rrezik domethënës. Nuk ka arsy, që të shmanget përdorimi i AIJS në përmirësimin e symptomave të infeksionit me Covid-19, nëse konsiderohet i nevojshëm. Çdo raportim subjektiv i rrezikut të përdorimit të AIJS në infeksionin me Covid-19 nuk është i konfirmuar apo i mbështetur në të dhëna shkencërisht domethënëse.

Referencia:

1. Moore N, Bosco-Levy P, Thurin N, Blin P, Droz-Perroteau C. NSAIDs and COVID-19: A Systematic Review and Meta-analysis. *Drug Saf.* 2021 Sep;44(9):929-938. doi: 10.1007/s40264-021-01089-5. Epub 2021 Aug 2. PMID: 34339037; PMCID: PMC8327046.
2. Robb CT, Goepp M, Rossi AG, Yao C. Non-steroidal anti-inflammatory drugs, prostaglandins, and COVID-19. *Br J Pharmacol.* 2020 Nov;177(21):4899-4920. doi: 10.1111/bph.15206. Epub 2020 Aug 27. PMID: 32700336; PMCID: PMC7405053.
3. Bianconi V, Violi F, Fallarino F, Pignatelli P, Sahebkar A, Pirro M. Is Acetylsalicylic Acid a Safe and Potentially Useful Choice for Adult Patients with COVID-19? *Drugs.* 2020 Sep;80(14):1383-1396. doi: 10.1007/s40265-020-01365-1. PMID: 32705604; PMCID: PMC7376326.

Një pasqyrë e tregut të infermieristikës në Shqipëri dhe në Evropë: Analiza SWOT.

Dr Indrit Bimi

¹Departamenti i shkencave teknike mjekësore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
indritbimi@uamd.edu.al

Abstrakt

Hyrje

Infermieria në Shqipëri ka bërë një evolucion dhe ky punim është një analizë e dobësive, kërcënimeve, pikave të forta dhe mundësive që përcaktojnë situatën aktuale të infermierisë në tregun shqiptar. Profesioni i infermierisë në Shqipëri po vuan nga një krizë migrimi në Gjermani dhe vende të tjera të BE-së për shumë arsyet.

Qëllimi

Ky artikull shqyrton literaturën e të gjitha studimeve ndërkombëtare dhe shqiptare dhe bën një analizë në lidhje me fuqinë punëtore infermierore në Shqipëri.

Metodat

Një rishikim i literaturës dhe analiza e përbajtjes së të dhënave u mblodhën duke kërkuar në PubMed dhe duke përdorur një shablon SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitetë dhe Kërcënimet).

Rezultatet dhe diskutimet

U gjetën artikuj në lidhje me pikat e forta, dobësitë, mundësitetë dhe kërcënimet dhe u vunë re rezultatet e vëzhguesa për vende të ndryshme.

Shumica e vendeve kanë problemin me arsimin që të rinjve nuk u pëlqen të studiojnë profesionin e infermierisë. Fuqia punëtore po plaket në Evropë. Ky qarkullim apo fluks migrimi i infermierëve në Shqipëri vjen për shkak të pasigurisë së punës, shperblimeve dhe pagave të ulëta, imazhit të zhvlerësuar të infermierëve në shoqëri dhe mungesës së njojjes së dimensioneve emocionale dhe psikologjike të kujdesit.

Konkluzione

Infermieria duhet të organizojë dhe zbatojë strategji në lidhje me problemet e tyre dhe të përmirësojë imazhin e tyre në shoqëri.

Fjalët kyçë: SWOT, infermieri, fuqi punëtore, imazh.

**Prevalenca dhe faktorët e rrezikut të Hepatitit B tek
pacientët e dializës dhe të qendrës talasemike në Q.S.U
“Nënë Tereza”, Tiranë.**

Msc. Irida Hoxha ¹

Prof. Asoc. Gentian Kasmi ²

Prof. Asoc. Manika Kreka ³

Prof. Dr. Linda Fuga ²

¹ Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, UAMD.

² Departamenti Mikrobiologjisi, Q.S.U “Nënë Tereza”, Tiranë

³ Departamenti OnkoHematologjisië Pediatrike, Q.S.U “Nënë Tereza” Tiranë.

irida.ikonomi@yahoo.com

Abstrakt

Hyrje: Pacientët në dializë (D) dhe talasemikë janë në rrezik të lartë për hepatit viral B për shkak të marrjes së transfuzioneve të gjakut, ekspozimit të lartë ndaj pacientëve të infektuar dhe paisjeve të kontaminuara.

Qëllimi: Ky studim ka si qëllim të përcaktojë prevalencën dhe faktorët e rrezikut në transmetimin e virusit të hepatitit B (HBV) në pacientët e dializës dhe talasemisë.

Materialet dhe Metodat: Studimi është kryer në periudhën kohore Mars 2015 -Mars 2019 në qendrën e dializës dhe talasemikëve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Janë skrinuar për HBsAg pacientët e dializës ($n= 267$) dhe talasemikë ($n = 148$). Të dhënat klinike janë konfirmuar me anë të kartelave klinike. Testi serologjik që është përdorur për dedektimin e HBsAg-së është Elisa Direkte.

Rezultatet: Prevalenca e HBsAg pozitiv ishte 7.7%, u vu re se 94% ishin pacientë të dializës dhe 6% ishin pacientë talasemikë. Transfuzionet e gjakut dhe kohëzgjatja e dializës ishte një faktor rreziku i rëndësishëm ($P < 0.03$) për infeksionin HBV.

Përfundimet: Transfuzioni i gjakut dhe kohëzgjatja e dializës janë faktorët kryesorë të rrezikut për infeksionin e hepatitit viral B në pacientët e dializës dhe talasemisë.

Fjalë kyçë: HBV, dializë, Tiranë

Manifestimet kardiake në pacientët me Covid-19

Dr. Mimoza Metalla (Keçi)¹
Msc. Fiona Metalla²

¹ Kardiologe, Spitali Rajonal Durrës
Specializante, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza,, Tirane

Abstrakt

Hyrje: Covid-19 shkaktoi një pandemi me impakt historik e cila pati pasoja të rëndësishmme në shëndetin kardiovaskular në mbarë botën. Pacientët me COVID-19 kanë një incidencë sinjifikative të manifestimeve kardiake të cilat shpeshhere janë përcaktuese në ecurinë e pacientit , manifestime të cilat shoqërohen me mortalitet shumë të lartë. Mekanizmat e prekjes kardiake, në COVID-19 janë: dëmtimi miokardial akut, i cili mund të shkaktohet nga ishemia, infarkti ose inflamacioni (miokarditi), hipoksemia, dëmtimi renal akut, hipervolemia, kardiomiopatia e induktuar nga stresi dhe aktivizimi inflamator sistemik i rëndësishëm (stuhia e citokinave) – karakteristikë e infeksionit sever dhe disfunkzionit multiorganor, aritmi kardiake të qëndrueshme, të përsëritura. COVID-19 mund të shkaktojë IK të djathtë ose globale të cilat duhet të trajtohen siaps udhërrëfyesve të shoqatës europiane të kardiologjisë. Impakti në sistemin kardiovaskular në infeksion COVID 19 mund të manifestohet në mënyrë akute ose mund të persistoje gjatë peridhës së konvaleshencës. Prognoza e pacientëve me sëmundje kardiovaskulare ose me disa faktorë rrisku si (Hipertensioni, Diabeti Melitus dhe Obeziteti) perkeqësohet pas infektimit me COVID-19. Dëmtimi kardiak akut manifestohet me rritje të troponinës sensitive kardiake, ProBnP- së, D-dimer. Studimet kanë treguar se rritja ekëtyre markuesve çon një prognoze jo të mirë të këtyre pacientëve . Duke pare qe nje nder mekanizmat kryesore ne Covid-19 eshte rritja e gjendjes protrombotike e inicuar nga infeksioni eshte vene re qe pacientet te cilet i neshtrohen nderhyrjes me Ptca me Stent ne pacientet me covid kane incidence me te larte te stent trombozes ne raport me pacientet qe nuk jane te prekur nga infeksioni me Covid 19

Objektiva: Qëllimi i këtij prezantimi do të jetë paraqitja e literaturave, studimeve si dhe e eksperiencës klinike spitalore dhe ambulatore tek pacientët e prekur me Covid 19 që kanë sëmundje kardiovaskulare bashkëshoqëruese dhe manifestimi akut apo kronik të prekjes së sistemit kardiovaskular në këta pacientë.

Materiale dhe Metoda: Literaturë e ndryshme, ku fjalët kyçe të përdorura kanë qënë infarkti akut i miokardit, Ptca me stent,insuficencia kardiake dhe COVID-19, si edhe eksperiencia klinike në pavionin e kardiologjisë dhe shërbimit ambulator pranë Spitalit Rajonal Durrës.

Konkluzione: Pandemia COVID -19 ka prodhuar efekte dramatike mbarë botërore në humbje të shëndetit apo te jetës sidomos tek të sëmurët me prekje kardiovaskulare.Pacientët me COVID-19 kanë inçidencë të lartë në prekjes kardiake ku manifestimet kryesore janë: Insuficiencia Kardiake, Shoku Kardiogen, Infarkt Akut Miokardi ose Ishemi, Disfunkcion Ventrikular te majtë ose të djathtë, Stent tromboza, Aritmie, Tromboemboli arteriale dhe venoze si pasojë e efektit prokoagulativ të virusit të cilat shoqërohet me mortalitet të lartë. Duhet minimizuar kontaktimit të COVID-19 të këtyre pacientëve. Është e rëndësishme që këta pacientë të ndiqen nga afër për të vënë diagnozën e hershme të COVID-19 dhe për të marrë masat parandaluese ndaj dëmtimit kardiak në mënyrë që të ulet mortaliteti në këtë grup pacientësh. Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të zbuluar mekanizmat e ndërveprimit të virusit me organizmin njerezor të cilat gjenerojnë përgjigje të ndryshme ndaj infekzionit për të përmirësuar strategjinë në parandalimin dhe trajtimin duke përfshire edhe efektet afatgjata kardiovaskulare të infekzionit me sars cov 2. Meqenëse janë popullatë me risk të lartë, të shihet me prioritet vaksinimi i tyre ndaj COVID-19.

Fjalët kyç: *Insuficiencë Kardiake, infarkt akut miokardi, Stenttromboza, aritmia COVID-19.*

Referanca:

- Sandoval Y, Januzzi JL, Jaffe AS. Cardiac troponin for assessment of myocardial injury in COVID-19: JACC review topic of the week.**J Am Coll Cardiol.** 2020; 76:1244–1258. doi: 10.1016/j.jacc.2020.06.068
- Bader F., et al. Heart failure and COVID-19. **Heart Fail Rev.** 2021 Jan;26(1):1-10. doi:10.1007/s10741-020-10008-2.
- Bravo MJB., et al. Heart Failure in the Time of COVID-19. **Cardiology.** 2020;145(8):481-484. doi: 10.1159/000509181.
- DeFilippis EM., Considerations for Heart Failure Care During the COVID-19 Pandemic. **JACC Heart Fail.** 2020 Aug;8(8):681-691. doi: 10.1016/j.jchf.2020.05.006. Epub 2020 Jun 3.
- Xiong TY, Redwood S, Prendergast B, Chen M. Coronaviruses and the cardiovascular system: acute and long-term implications.**Eur Heart J.** 2020; 41:1798–1800. doi: 10.1093/euroheartj/ehaa23
- <https://www.who.int/publications/m/item/summary-of-probable-sars-cases-with-onset-of-illness-from-1-november-2002-to-31-july-2003>.

Profili i faktorëve të rriskut dhe ecuria klinike në pacientët me infarkt akut të miokardit në qarkun Durrës. Diferencat sipas grupmoshave.

Eliverta Zera¹

Ira Xhemollari²

Sonila Xinxo³

¹ Kardiologe, Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt

Hyrje. Infarkti akut i miokardit (IAM) ndodh kryesisht ne individe mbi 45 vj dhe eshte me i rralle nen 45 vj. Pacientet ne moshe te re ndryshojne ne menyra te ndryshme nga ata me moshe me te madhe.

Qellimi. Te vleresoje diferenzen e FR, profilit angiografik, ecurine e IAM midis grupmoshave.

Pacientet dhe metoda. U përfshinë 499 pacientë me IAM të moshës 18 deri ne 90 vj gjate nje periudhe 3 vj sipas një protokolli të aprovuar nga Dep. Kardiologjisë. U ndanë në grupmosha cdo 10 vjet, nga 25-44 vj e në vazhdim deri > 85vj. U analizuan FR, ecuria e IAM në spital, lokalizimi dhe komplikacionet, vdekshmëria e hershme për cdo grupmoshë, Analiza statistikore u krye me SPSS 16.0. Vlera e p <0.05 u konsiderua statistikisht sinjifikante.

Rezultatet. Nga 499 pacientë me IAM, 19(3.8%) i përkasin grupmoshës 25-44 vj ku meshkujt me IAM janë në numër më të madh krahasuar me gratë e kesaj grupmoshe (85.9% vs 10.5%, p 0.001) e me rritjen e moshes ulet nr meshkujve e rritet nr femrave me IAM. Krahasuar me moshat e vjetra,ne moshat e reja predomonon obeziteti (63.1%), duhanpirja (63.1%), nivele të larta të triglicerideve (26.3%) dhe nivele me te uleta te HTA, diabetit e kolesterolit.Në grupmoshën 25-44 vj është i lartë numri i pacientëve me 3 faktorë rrisku (42.1%) dhe ≥ 4 faktorë rreziku (15.8%). Shfaqet më tepër Infarkti inferior se anterior (63.1% vs 36.8% p 0.03). Grupmoshat e reja i nënshtrohen më tepër angiografisë (57.8% p 0.01) e marrin më tepër terapi revaskularizuese (100%. p 0.018). Shfaqin me pak komplikacione se moshat e vjetra. Vdekshmëria në grupmoshat 25-44 vjec është e lartë 15.7% %, ka një rënie në grupmoshat e tjera e shfaqet sërisht e lartë në grupmoshat mbi 85 vj (17.2%) P 0.002.

Konkluzion. IAM ndodh me shpesh ne meshkujt e moshes se re qe kane mbi 3FR dhe Obeziteti Dislipidemia,Duhanpirja jane FR me te shpeshte. Marrin me teper terapi revaskularizuese e kane me pak komplikacione e vdekshmeri te larte krahasuar me me te vjetrit.

Fjalet kyc. IAM, FR, grupmoshat

Ndikimi i çrregullimeve hormonale me baze ovarin mikrokistik në shfaqjen e akneve tek moshat e reja

Dr. Migena Prifti ¹
Dr. Brizida Refatllari ²

¹ Gjinekologe, Spitali Rajonal Durrës
² Universiteti i Mjeksisë i Tiranës

Abstrakt

Hyrja: Kur flasim per moshat e reja tek femrat i referohemi kryesisht moshes mbi 18 vjeë, pikerisht periudhes se pjekurise hormonale dhe rritjes se kerkeses qe ka kjo moshe per cilesine e jetes. Eshte kjo faze ku ankesat e para jane ne kerkim te dermoestetikes per daljen e pucrrave apo njollave ne lekure. Tashme eshte vertetuar se kjo ka lidhje te drejtperdrejte me bilancin hormonal, kryesisht ovarian. Kjo eshte dhe baza e ketij studimi per te nxjerre me pah korrelacionet e drejta dhe te ndersjellta te ketyre patologjive: gjinekologjike dhe dermatologjike.

Qellimi: Venia ne dukje e lidhjeve te ndersjellta qe ekzistojne midis problemeve hormonale dhe atyre dermatologjike ne grupmoshen 18-30 vjec si dhe sensibilizimi i kesaj grupmoshe per te kerkuar konsultat e duhura dhe mjekimin adekuat per problemet e tyre.

Metoda e studimit: eshte perdorur nje studim prospektiv, pasi pacientet ndiqen ne dinamike prej nje periudhe kohore 6 muaj dhe ne vazhdim nen konsulta gjinekologjike dhe dermatologjike. Te dhenat e mbledhura jane vendosur ne tabela 2*2 per te nxjerre me ne pah faktoret e rriskut me te rendesishem si dhe mjekimin me adekuat. Jane ndare ne 2 grupe studimi ne varesi te mjekimit gjinekologjik te ndjekur: me baze zevendesimin hormonal dhe ate te rritjes se imunitetit.

Rezultatet: Jane paraqitur ne klinike 24 paciente, 18 prej te cilave kishin ankesa kryesore acarimin e ftyres dhe vinin pas nje konsulte dermatologjike, kurse 6 per çrregullime te ciklit menstrual. Ne ndarjen sipas grupmoshave 72% e tyre i perkisnin asaj studentore. Te gjitha dolen ne te dhenat ekografike me sindromin e ovarit mikrokistik dhe 30% e tyre me ndryshime te lehta te bilancit hormonal LH-FSH, nderkohe qe tek pacientet me vonese cikli 80% e tyre kishin te larte prolaktinen. Ne 70% te rasteve u vu re prania e infeksioneve genitale deri ne pranine e kist ovari ose SIP.

Fjalet kyce: akne, çrregullim cikli, bilanc hormonal, SIP.

Kujdesi infermieror tek pacientet post operacioneve plastike gjinekologjike

Gisela Albrahimi ¹

Dr. Migena Prifti ²

¹ Gjinekologe, Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt

Hyrja: Vitet e fundit eshte pare nje rritje e numrit te pacienteve qe kane kryer operacione plastike gjinekologjike, per arsye estetike ose shendetesore. Operacionet plastike gjinekologjike qe kryehen me se shumti ne Shqiperi jane: labiaplastika, perineoplastika, vaginoplastika, himenoplastika ne te cilat jepet kujdesi infermieror perkates per secilin prej tyre.

Objektivat: Qellimi i ketij studimi eshte paraqitja e menaxhimit infermieror tek pacientet qe kane kryer operacione plastike gjinekologjike dhe per te treguar se sa i rendesishem eshte kujdesi post operator i ketyre rasteve per te perjashtuar komplikacionet e mundshme.

Metodat: Ky eshte nje studim prospektiv i cili eshte bazuar ne rastet qe jane paraqitur prane klinikes tone gjate vitit te fundit, ndermjet grupmoshave 40-60 vjec. Cdo pacient eshte diagnostikuar dhe trajtuar brenda nje periudhe 1-2 mujore.

Rezultatet: Nga 23 paciente te paraqitura ne kliniken tone, relativisht 13 prej tyre jane diagnostikuar me cystocele ose rectocele, 6 paciente me laceracione te pakorrigjuara pas lindjes dhe 4 prej tyre donin qe te kishin nje pamje me estetike te zones se tyre genitale. Te gjitha pacientet ishinndermjet grupmoshave 40-60 vjec ku kujdesi infermieror perkates eshte dhene ne cdo moment, nga procedurat diagnostikuese deri tek kujdesi post operator dhe edukimi shendetesor ne shteti.

Konkluzionet: Te gjitha rastet e paraqitura ne kliniken tone i jane nenshtruar procedurave kirurgjikale ne repartin e Gjinekologjise, ne Spitalin Rajonal te Durresit. Me pas rastet jane ndjekur ne dinamike ne klinike, pas operacionit plastik me kujdesin infermieror perkates dhe kemi pasur nje feedback pozitiv. Asnje nga pacientet nuk ka pasur komplikacione pas operacionit dhe ishin te kenaqura me rezultatet.

Fjalet kyce: Operacion plastik, kujdesi infermieror, gjinekologji.

Dakriocistorinostomia me dhe pa stent silikoni. A ka ndonjë ndryshim domethënës në rezultate?

Alfred Aga¹
Klaudia Stajka¹

¹ Universiteti i Mjeksisë i Tiranës

Abstrakt

Qëllimi: Për të krahasuar diferencën midis rezultateve të dakriocistorinostomisë endoskopike endonazale (En-DCR) me dhe pa tub silikoni (stent) për trajtimin e dakriocistit primar dhe dakriocistit flegmoz.

Metoda: Studim krahasues retrospektiv i 111 subjekteve të operuar për dakriocistit nga tetori 2014 deri në maj 2021, nga të cilët 60 ishin me stent dhe 51 ishin pa stent silikoni. Tubat e silikonit u mbajtën në rruget lakrimale për 3 muaj. Kryhet ndjekja e operacionit nga 3 deri në 6 muaj dhe ndërlikimet per cdo pacient. Kirurgjia u përkufizua e suksesshme kur nuk kishte evidencë të epiforës postoperative, sekrecioneve purulente, infeksionit, granulomave, përsëritjes së dakriocistit, pas vlerësimit endoskopik endonazal.

Rezultati: Janë shqyrtuar gjithsej 111 procedura endoskopike të njëpasnjëshme të dakriocistorinostomisë transnazale të kryera në Spitalin Amerikan 1, Tiranë nga tetori 2014 deri në maj 2021. Nga 111 pacientë me dakriocistit akut, 60 (54.05%) janë trajtuar me stent silikoni (grupi A) dhe 51 (45.94%) janë trajtuar pa stent silikoni (grupi B). 20 nga 111 (18%) u diagnostikuani me dakriocistit flegmoz nga të cilët 7 (11.67%) ishin pjesë e grupit A dhe 13 (25.49%) ishin pjesë e grupit B. Pacientet u ndoqen me kontolle endoskopike per gjate gjashtë muajve. Vetëm 7 pacientë (11.66%) në grupin A patën komplikime si sekrecione purulente (2 ose 28.57%), infeksion (3 ose 42.85%), epiforë (1 ose 14.28%), granuloma (1 ose 14.28%) dhe asnjë në grupi B kishte ndonjë prej tyre. Në pacientët me dakriocistit flegmoz nuk u konstatuan komplikime.

Konkluzioni: Dakriocistorinostomia me dhe pa tub silikoni janë dy procedura të ndryshme pa ndonjë ndryshim të rëndësishëm në shkallën e suksesit. Bazuar ne ndërlikimet e tij, ky studim mbështet rutinën pa stent silikoni, duke sugjeruar që stentet nuk janë të nevojshme ne dakriocistorinostomite paresore.

Fjalë kyçe: En-DCR, tub silikoni (stent), dakriocistit, dakriocistit flegmonoz, dakriocistorhinostomi.

Nje rast me alport sindrome

Dr. Enno Qerimi¹

¹ Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt

Qëllimi Investigimi i nje rasti me nje sindrom te rralle Alport.

Materialet dhe Metodat: Case report.

Rezultatet: Pacienti erdhi ne Spital me nje ulje te shikimit ne te dy syte.

Gjate ekzaminimi te segmentit anterior dhe posterior rezultoi cataracte ne te dy syte dhe nje forme e vecante e kristalinis lentikonus anterior.

Pacienti iu nenshtrua kirurgjise per katarakten me tekniken me ultratinguj ne te dy syte dhe me implantim te lentes kamera posterior. Ai kishte ulje bilaterale te degjimit dhe semundje renale kronike.

Konkluzioni: Ne raste te tilla duhet marre nje anamneze e hollesishme per te zbuluar nese problemi okular eshte lokal apo pjese e nje sindromi te rralle.

Asthma bronchiale si komorbiditet ne COVID-19

Dorina Qerimi¹
Enno Qerimi¹

¹ Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt

Hyrje: Ne Mars te vitit 2020 OBSH shpalli gjendjen e Pandemise Globale nga SARS-COV-2, e ne vazhdim COVID-19 u perhap me shpejtesi ne te gjithe boten. Nje semundje me imunopatologji dhe fizpatologji te tille qe e lejon te kete manifestime klinike te shumellojshme.

Objektivat: Te demonstroje impaktin qe ka asthma mbi dekursin dhe prognozen e Covid-19.

Materialet dhe Metodat: Ne muajt e pare te pandemise. Asthma Bronchiale se bashku me Hipertensionin Arterial, Semundjet Kardiovaskulare, Diabet Mellitus dhe Semundjet Renale Kronike u konsideruan si faktore rishku ne dekursin dhe prognozen e infeksionit nga SARS-COV-2. Tashme jemi ne vitin e dyte pandemise dhe ka ende te panjohura mbi COVID-19, e mbi impaktin qe kane semundjet bashkeshoqueruese ne te.

Rezultatet: Covid-19 mund te paraqitet edhe me shenja neurologjike: cefale, delir, axhitim stroke, encefalopati, meningo-encefalit, demtitm i shijes, nuhatjes, ankth, depression konfuzion. Dekursi klinik i infeksionit nga Sars CoV 2 varet nga disa faktore te lidhur me dozen virale, perggjigen immune te individit, dhe faktore te tjere rishku si smundjet bashke shoqueruese (Duhanpirja, obeziteti, diabeti, etj). Fakti qe disa te dhena te deritanishme jane ne favor te hipotezes qe Astma. apo alergjia Tipi 2(te shoqueruara me inflamacion eozinofilik) karakterizohet nga ulja e ekspresionit te ACE2 ne epitelin e rrugeve te ajrit, mund te jete nje shpegim pse rishku per gravitet te Covid -19 ne keta paciente eshte i ulet.

Konkluzion: Studimet e publikuara dhe te dhenat e deritanishme indikojne se ASTHMA BRONCHIALE preekzistuese nuk perben faktor rishku per nje prognoze me te rende te COVID-19.

Fjale Kyce: asthma bronchiale, covid-19, komorbiditet

Artriti dhe COVID-19

Genti Kavaja¹

Silvana Tonuzi²

Bora Kavaja³

¹ Reumatolog, Spitali Rajonal Durrës, Shqiperi

² Spitali Rajonal Durrës, Shqiperi

³ Fakulteti I Mjekesise, Universiteti Mjekesise, Tiranë

*gentikavaja@hotmail.com

Abstrakt

Simptomat muskuloskeletale jane te zakonshme ne rastet e infeksioneve nga Covid 19 duke variuar nga 10 deri ne 25% te pacienteve. Simptomat kryesore jane artralgjia, lodhja, lumbalgia dhe mialgjia. Megjithese rruga e aktivizimit te citokinave dhe nxitjes se inflamacionit te evidentuar ne rastet me Covid 19 eshte e ngjashme me rrugen e ndjekur ne semundjen e artritit reumatoid, shoqerimi I artritit me infeksionin SARS-CoV-2 nuk haset shpesh dhe simptomat zakonisht jane akute dhe kalojne pas nje periudhe te shkurter kohore.

Nje pacient i moshes 28 vjec paraqitet me simptoma te nje sindromi inflamator kalimtar qe shoqeronte nje infeksion nga SARS-Cov-2 dhe me pas shfaq nje artrit kronik. Per nje periudhe 2 mujore ishte trajtuar me analgjezike dhe AIJS. Me paraqitjen ne klinike u fillua perdonimi I kortikosteroideve duke cuar ne ulje te intesitetit te klinikes pas tre javeve dhe permiresim te ndjeshem. Testi serologjik per SARS-CoV-2 ishte pozitiv ne javen e katert te fillimit te simptomave. Aktualisht pacienti eshte ne monitorim dhe klinikisht gjendja eshte e mire por vazhdon te kete ngurtesim mengjesor, nxehtesi lokale ne artikulacionet e vogla me hipertrofi te sinovias dhe vlera te larta te treguesve te inflamacionit (PCR dhe ertitrosedimenti).

Ne keto rrethana nuk mund te perjashtohet lidhja midis infeksioneve virale dhe vendosjes se artritit. Kjo kerkon studime te metejshme per te percaktuar nese ky eshte nje episod rastesor apo nje mbeshtetje per lidhjen etiologjike me infeksionin SARS-CoV-2.

Fjale kyc: artriti, covid-19, tregues te inflamacionit

Post covid- 19 sindrome,nje sfide e re

Dr. Edlira Ndreu¹

¹Pneumologe, Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt

Hyrje: Termi post covid sindrome ose covid i zgjatur, permblehd rrëth 200 simptoma te ndryshme qe prekin 10 sisteme te cilat persistojne mbi 4 javë deri ne disa muaj pas kalimit te infeksionit nga Covid 19. Individet me post covid sindrome kane ndikim ne statusin fizik dhe konjiktiv perfshire ketu kufizimin ne aktivitetet te perditeshme, si veshja ose berja e dushit, ulja e aftesise per tu kujdesur per veten ose familjen, veshtiresi per tu rikthyer ne pune dhe rritje e nevojes per te mare kujdes shendetesor. Sidoqoftë prevalencia varion gjeresisht ne varesi te faktoreve sic jane; mosha, semundjet shoqueruese, shkalla dhe graviteti i infektimit nga Covid 19. Pacientet shfaqin probleme te zgjatura me frymemarrjen, komplikacione te zemres, veshkave, melcise, G-I,hematologjike e imunologjike, neurologjike, psikologjike,ne shtatzani dhe shendetin riprodhues.

Objektiva: Qellimi i prezantimit eshte paraqitja e te dhenave nga studimet e huaja dhe pervojes tone klinike me pacientet e hospitalizuar me post COVID -19 sindrome ne SRD si dhe paraqitja e komplikacioneve afatgjata te COVID-19.

Materiale dhe metoda: Literatura te ndryshme ky fjala kyce ka qene COVID-19, POST COVID-19 syndrome,komplikacione,studime te bera ne vendet e huaja,te dhena nga aplikacioni COVID symptom study.

Përfundime: Nderkohe qe studime te metejshme me grupe me te gjera dhe te dhena me te detajuara nevojiten per te kuptuar mekanizmat me te cilat COVID-19 shkakton nje game kaq te gjere komplikacionesh, ne si ekip mjekesor duhet te monitorojme ne menyre te kujdeshme funksionin e te gjitha organeve jetesore si celesin kryesor te mbijeteses se pacienteve.

Ekograifa e mushkërive në pacientët me covid 19 dhe jo vetëm – metoda, rezultatet, perspektiva

Dr. Elton CEKAJ ¹

¹ Radiolog, Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt

Hyrje: COVID 19 me të drejtë ende tërheq vëmendjen e të gjithë qarqeve mjekësore kudo në botë. Sigurisht klinika dhe epidemiologjia zënë vendin kryesor në diagnozë, por pa imazherinë situata do të ishte shumë kaotike. Siç edhe dihet tashmë nga të gjithë, radiografia dhe skaneri janë metodat kryesore të diagnostikimit imazherik të COVID 19. Radiografia është metodë shumë e mirë diagnostikimi për vlerësimin e pacientëve me ankesa nga probabël COVID 19 por të dhënët radiologjike janë evidente vetëm nëse prekja e mushkërive është e moderuar e më shumë, nëse përdoren radiografi digitale dhe nëse pacientët bashkëpunojnë. Skaneri ose tomografia e kompjuterizuar, është ende metoda e zgjedhur diagnostike imazherike, sidomos me rezolucion të lartë, shërben për stadifikimin imazherik të sëmundjes e përcaktimin e prognozës imazherike, por është shumë e kushtueshme, nuk është kudo prezente dhe kurdoherë e vlefshme, sidomos për pacientët që nuk mund të transportohen apo pacientët e reanimacioneve. Ekografia e pulmonit, e përdorur deri më sot për vlerësimin e patologjive kardiakë apo të patologjive të periferisë së pulmonit, është gjetur se është shumë e vlefshme për vlerësimin e pacientëve me COVID 19, për të vedosur diagnozën, për ndjekje të ecurisë dhe për prognozën e rasteve të rënda në shtrat.

Misioni dhe vizioni: Të provojë që ekografia e pulmonit është metodë e vlefshme për vlerësimin e pacientëve të dyshuar apo të dignositikuar me COVID 19 si edhe për ndjekjen e ecurisë së tyre. Ky do të jetë gur themli ne misionin për mundësimin e përcaktimit të qartë të protokollit të ndjekjes së pacientëve në reanimacione, pacientëve të pamundur në shtrat apo të atyre ne zona apo qendra ku CT nuk ëhstë e mundur.

Metodat dhe konkluzione: për vlerësimin ekografik të pulmonit në pacientët me COVID 19 është e nevojshme një apparat ekografie me sonde sektoriale me frekuencë të ulët (kardiakë apo abdominale). Planet e skanimit dhe mënyra e skanimit janë tashme të mirë përcaktuara. Skanimi fillon me planet anteriore medioclavicular axiale longitudinale e me pas me planet axila dhe longitudinale ne linjën axillare e më pas me skanimet posterolaterale medioaxillare si majtas edhe djathtas.

Gjatë ekzaminimit është e domosdoshme identifikimi i linjave B (me shumë se tre), efuzionit pleural apo konsolidimit pulmonar me anë të të cilave vlerësohet gjendja me pikë. Pozitiviteti i metodës kur realizohet saktë është shumë i lartë dhe i krahasueshëm me skanerin e toraksit

Fjalët kyçe: COVID 19, Linja B, Linja A, efuzion pulmonar, konsolidim pulmonar

Referenca:

- Gattinoni L, Chiumello D, Caironi P, Busana M, Romitti F, Brazzi L, et al. COVID-19 pneumonia: different respiratory treatments for different phenotypes? *Intensive Care Med.* 2020 Jun; 46(6): 1099–102.
- Lichtenstein DA. BLUE-protocol and FALLS-protocol: two applications of lung ultrasound in the critically ill. *Chest.* 2015;147(6):1659- 1670. doi:10.1378/chest.14-1313.
- Pascarella, G. et al. COVID-19 diagnosis and management: A comprehensive review. *J. Intern. Med.* **288**, 192–206 (2020).
- Okonkwo, N. E. et al. COVID-19 and the US response: Accelerating health inequities. *BMJ Evid.-Based Med.* <https://doi.org/10.1136/bmjebm-2020-111426> (2020)
- Lu, W. et al. A clinical study of noninvasive assessment of lung lesions in patients with Coronavirus Disease-19 (COVID-19) by bedside ultrasound. *Ultraschall der Medizin – Eur. J. Ultrasound.* **41**(03), 300–307 (2020)
- Ai, T. et al. Correlation of chest CT and RT-PCR testing in coronavirus disease 2019 (COVID-19) in China: A report of 1014 cases. *Radiology* **296**, 32–40 (2020).

Traumat sportive gjatë një loje futbolli

MSc. Elda Latollari¹

MSc. Selda Veizaj²

¹*Fizioterapiste Akademia e Futbollit Skënderbeu, Lektore Universiteti Fan Noli*

²*Lektore Universiteti Aleksander Moisiu*

Abstrakt

Hyrje: Lëndimet janë të mundshme kur luani sport nëse jeni një atlet profesionist ose jeni duke luajtur për argëtim. Ju mund të shmagjë lëndimet e zakonshme sportive duke marrë masa paraprake si përdorimi i pajisjeve dhe teknikave të duhura për secilin sport.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të rehabilitojë sa më shpejt traumat sportive gjatë një lojë futbolli. Objektivat kryesore që arritëm të realizojmë me anë të këtij studimi janë:

- Të arrijë të evidentojoj llojin e traumës së ndodhur
- Të rehabilitojë në mënyrë sa më të shpejtë sportistin
- Te rikthejë sa më shpejt në lojë futbollistik

Metodologjia: Ky studim është i tipit përshkrues analistik. Në studim janë përfshirë 4 skuadra (U13, U15, U17, U19) secila me 20 individë. Futbollistët u ndoqën për një periudhë dy mujore tator -dhjetor 2021. Traumat që u morën në studim janë traumat e ndodhura gjatë lojës sportive. Traumat u ndanë në tre kategori kryesore: Trauma të lehta, të moderuara dhe të rënda. Canta e ndihmës së shpejtë përmban janë: spray freskues. Krem nxehës, krem kundër dhimjes, ilace intramuskulare kundër dhimbjes, fasha të thjeshta, fasha elastike, diazepam, adrenalinë IM/IV

Rezultate: Traumat e lehta përfshijenë 50% të rasteve dhe përfshijnë: goditjet me këpucë, plagosjet e lehta (gërvishtje të lëkurës, gjakderdhje nga hundët)/ Traumat e moderuara përfshijnë 30% të rasteve dhe janë tërheqjet muskulare, kontraktura muskulare, sindromi patellofemoral ndrydhjet, hematomat muskulare, ndërsa traumat e rënda përfshijnë 20% të rsateve dhe janë: këputje të meniskut, goditjet në kokë, dalja e kaviljes. Rehabilitimi konsistonë: fazë akute spray freskues, akull, imobilizime me fasha, ndërsa më vonë pushim masazh, stretching lëvizje pasive, active, ushtrime me zinxhir të mbyllur, te hapur, ushtrime stabiliteti, terapia me kupa.

Konkluzione: Pas analizimit dhe diskutimit të dhënavë të mbledhura u vu re se traumat e lehta trajtohen dhe rehabilitohen më lehtë, ato të moderua kërkojnë më shumë kohë për tu rehabilituar, ndërsa traumat e rënda rehabilitohen më gjatë por mund ti kushtizojnë karrierën e sportistikët, por mbi të gjitha janë shumë stresuese dhe per stafin mjekosor.

Fjalë kyce: trauma, ushtrime, masazh, futboll

Emergency management and treatment of sudden cardiac arrest (sca)

Basri Lenjani¹

Esen Uysal²

Adem Zalihic²

Aida Gavranovic²

Kenan Ljuhar²

Nehra Jonuz Gusic²

Dardan Lenjani³

¹University Hospital and Clinical Service of Kosovo Emergency Clinic

²Emergency Medical Center of Canton Sarajevo

Huzur Mahlesi, Serçe Sokak No:9 Deniz Apartmanı daire 9 Narlidere/Izmir

Turkey²

Abstrakt

Arresti i papritur kardiak (SCA) është një gjendje emergjente jetëkërcënuese, në të cilën zemra papritur ndalon së rrahuri. Nëse kjo ndodh, gjaku ndalon të rrjedhë në tru dhe në organet e tjera vitale. SCA zakonisht shkakton vdekje, nëse nuk trajtohet brenda pak minutash. Kardiomiopatitë përbëjnë gati gjysmën e rasteve SCA/D tek atletët profesionistë, ndërsa anomalitë e arterieve koronare luajnë një rol më të spikatur sesa pritej te atletët e shkollave të mesme. SCA përbën 15-20% të të gjitha vdekjeve natyrore në të rriturit në SHBA dhe Evropën Perëndimore, dhe deri në 50% të të gjitha vdekjeve kardiovaskulare Incidenca e vdekjes se papritur kardiake ndodh më shpesh tek të rriturit në mesin e të 30-tave deri në mesin e të 40-ve dhe prek meshkujt dy herë më shpesh sesa gratë. Nëse nuk trajtohet menjëherë, arresti i papritur kardiak mund të çojë në vdekje.

Nëse nuk trajtohet menjëherë, arresti i papritur kardiak mund të çojë në vdekje. Mbijetesë është e mundur me kujdes të shpejtë dhe të duhur mjekësor. Reanimimi kardiopulmonar dhe përdorimi i defibrilatorit, AED, barnave mund të përmirësojë shanset për mbijetesë.

Fjalet kyqe. Arresti i papritur kardiak, sulmi në zemër, SCA, RKP, vdekjet natyrore, defibrilatori, AED, SHME 112

Stroke dhe Covid -19

Dr. Edlira Harizi¹

¹ Shefe e sherbimit te Neurologjise, Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt

Hyrje dhe Qëllimi: Pacientet e infektuar me COVID-19 mund te zhvillojnë tromboze arteriale duke perfshire goditjen ne tru (stroke). Faktore te shumte rreziku te lidhur me COVID-19, mund te kontribuojnë ne rritjen e ashpersise dhe fillimin me te hershern te goditjes akute ishemike, duke perfshire hiperkoagulueshmerine e per gjithesuar, per gjigjen imune te rrregulluar qe con ne sindromen e clirimit te citokines, derntimin e qelizave endoteliale qe con ne rritjen e inflamacionit dhe trombozes, dhe hipoksemine e lidhur me deshtimin kardiorespirator. Ky rezultat ka perfshire nje incidence ne rritje te goditjes ne tru ne pacientet me te rinj ose paciente pa faktore rreziku paraprak per goditje ne tru.

Metoda: Ne studimin tone kemi pare numrin e pacienteve to sheruar me Goditje ne Tru ne Departamentin e Neurologjise ne SRD ne periudhen 1 Prill 2020 - 1 Prill 2021. Kemi patur gjithsej 722 raste me diagnoze Goditje dhe 43 prej tyre kane qene COVID-19 pozitiv (5.9%), 23 ishin femra 20 ishin meshkuj. Nga pacientet me COVID-19 pozitiv, 22 paten goditje te rende, 51% goditje te rende me mbyllje te eneve te medha dhe 9 prej tyre bene exitus letalis ditet e para. Dy paciente te ketij grupi nuk kishin faktore rreziku te njobur dhe kishin moshe mesatare 58.5 vjec (meshkuj). Pacientet e tjere me infarkt te rende kishin moshen e mesme 73,6 vjec dhe si faktore rreziku hipertensionin 72,2%, fibrilacionin atrial 56%, diabetin mellitus 38,7%, hiperlipidemine 62%, kardiopatine ishemike 35% dhe goditjen e meparshme 22,7%. Ky grup pacientesh me goditje to rende ne tru kishte te gjitha implikimet pulmonare me insuficience respiratore dhe hipoksemi. Pacientet e tjere me COVID pozitiv 49% (21) kishin goditje te moderuar dhe te lehte. 28,5 % (6) nuk kishin faktore rreziku, pacientet e tjere te ketij grupi kishin hipertension 57%. diabet mellitus 27%, fibrilacion atrial 35%, hiperlipidemia 58%, kardiopati ishemike 26%. Mosha mesatare e ketij grupi ishte 66.7 vjec dhe kishte sherim te mire.

Konkluzione: Ne studimin tone, kemi vete re nje lidhje te ngushte te goditjes ne tru me COVID-19. edhe ne paciente pa faktore risku te njobur me pare. Ndaj studime te metejshme me te detajuara nevojiten per te pare me thelle kete korrelacion.

Angiografia Koronare Me Ct E Krahasuar Me Koronarografinë Për Vlerësimin E Sëmundjes Së Arterieve Koronare Në Qsu "Nënë Tereza" Tiranë

Endri Hasimi
Shyqyri Hasimi

Abstrakt

Sfondi Teorik: Prevalenca e Sëmundjes së Arterieve Koronare (SAK) në Shqipëri ka ardhur në rritje të vazhdueshme nga viti 1990, së bashku me mortalitetin dhe ditët e paaftësisë të lidhura me të. Dy ekzaminimet të cilat vizualizojnë në mënyrë direkte arteriet koronare janë koronarografia dhe Angiografia Koronare me Tomografi të Kompjuterizuar (CCTA). Koronarografia mbetet standardi i artë për vlerësimin e stenozave në arteriet koronare dhe përcaktimin e indikacionit terapeutik, por që mbart rreziqet e ekzaminimit invaziv. CCTA nga ana tjeterë është një ekzaminim jo-invaziv, i cili falë përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë dhe përfshimit të imazheve me cilësi të lartë dhe dozë rrezatimi të ulët, si dhe rezultateve të studimeve të shumta për vlerë prediktive negative të lartë, është kthyer në një nga themellet e vlerësimit të SAK.

Qëllimi: Vlerësimi i saktësisë diagnostike (sensitiviteti, specificiteti, vlera prediktive pozitive dhe negative për pacient, për arterie dhe për segment) të Angiografisë Koronare me Tomografi të Kompjuterizuar (CCTA) me 64 detektorë që realizojnë 128 prerre, e krahasuar me koronarografinë si standart i artë për vlerësimin e Sëmundjes së Arterieve Koronare në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.

Metodologjia: Ky është një studim observacional kros-seksional i bazuar në regjistrat e raporteve të CCTA dhe të koronarografisë. Në të u përfshinë 440 pacientë që kanë kryer CCTA dhe më pas koronarografi brenda 1 muaji nga CCTA, në QSU "Nënë Tereza" Tiranë gjatë periudhës Dhjetor 2012 – Nëntor 2018. CCTA u krye me skaner të tipit Siemens Somatom Definition AS+ me 64 detektorë që realizojnë 128 prerre. Rikonstruksioni i imazheve bëhej automatikisht nga programi në sekuencën best diastole dhe me kernel 0.26f dhe 0.46f. Në rast artefakteve apo imazhesh jo-diagnostike provoheshin rikonstruksione të tjera në fazë të ndryshme të ciklit kardiak apo duke fshirë ekstrasistolat e paparashikuara. Interpretimi bëhej me 3 projeksione MIP ortogonale me akset kardiake si dhe me Curved MPR. Segmentet koronare u vlerësuan me 0 në rast mungese të stenozave obstruktive, 1 për stenoza 50-75%, 2 për stenoza >75%, 4-kalibër <2 mm, 5-artefakt, i cili praktikisht u konsiderua si stenozë obstruktive përderisa nuk përjashton dot SAK. CCTA konsiderohet pozitiv nëse diagnostikon të paktën një segment me stenozë obstruktive $\geq 50\%$ që detyron kryerjen e koronarografisë.

Rezultatet: Sensitiviteti i CCTA për diagnostikimin e stenozave obstruktive në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë ishte 79%, 93% dhe 98% përkatësish për segment, për arterie dhe për pacient. Specificiteti ishte përkatësish 83%, 59% dhe 33%. Vlera Prediktive Pozitive ishte përkatësish 36%, 45% dhe 68%, ndërsa Vlera Prediktive Negative ishte 97%, 96% dhe 92%. Për segmentet e stentuara sensitiviteti, specificiteti, VPP dhe VPN ishin përkatësish 71%, 35%, 21% dhe 83%. Për graftet e CABG sensitiviteti, specificiteti, VPP dhe VPN ishin përkatësish 100%, 60%, 41% dhe 100%.

Konkluzione: CCTA në QSU “Nënë Tereza” Tiranë ka sensitivitet dhe VPN shumë të lartë, të ngjashme me studimet e tjera që tregon për aftësi shumë të mirë përjashtuese të SAK të arterieve native, por specificitet dhe VPP të ulët, që flet për falls-pozitivitete të shumta, shpesh të lidhura me artefakte. CCTA nuk është një metodë e favorshme për vlerësimin e stenteve, sidomos në popullatën tonë ku pacientët nuk kanë dokumentacion për diametrat dhe mbivendosjet e stenteve. CCTA ka sensitivitet dhe VPN të lartë për përjashtimin e stenozave të grafteve të CABG por nuk vlerëson dot arteriet native te këta pacientë.

Njohuritë për menaxhimin e eklampisë në maternitetin “Mbretëresha Geraldinë” nga mami-të dhe infermierët

Msc. Daniela Bimi¹

¹Materniteti “Mbreteresha Geraldine” Tirane

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimet hipertensive komplikojnë 10-20% të shtatzënive dhe përbëjnë shkakun madhor të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare dhe fetale. Präklampsia shfaqet afërsisht në 5% të të gjithë shtatzënive, 10% tek primiparet dhe 20-25 % tek gratë me histori të mëparshme për hypertension arterial. Eklampsia komplikon 1 në 2000 shtatzëni.

Qellimi i studimit: Është njohja me patologjite e preeklampsise, eklampsise dhe vlerësimi i njohurive dhe aftesive ne lidhje me manaxhimin e eklampsise ne infermieret dhe mami-te ne Maternitetin “Mbreteresha Geraldine, Tirane.

Materiali dhe metoda: Studimi është kros-seksional dhe jane marrë ne pyetje infermiere dhe mami. Janë përfshirë ne nje pytesor te formuluar nga une me referenca të huaja. Janë pyetur 20 infermiere/mami në Maternitetin “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë.

Rezultatet dhe diskutimet: Shihet një predominancë e personelit të shkolluar në kurse 2 vjecare, 9 mujore, por që kohët e fundit janë shkolluar në ciklet bachelor pranë disa Universiteteve shqiptare. Gjithashtu vërehet qe stafi eshte me experience me shume se 20 vite. Shikohet që përfthimi i manaxhimit të eklampsise prezupozohet që është mësuar gjate eksperiencës klinike, ndërsa në një përqindje prej 60 % thuhet që është mësuar gjatë shkollës. Të mësuarit është e lidhur me vjetërsinë në punë. Por shikohet që ka nje predominance të brezit që ka eksperiencë mbi 20 vjecare.

Konkluzionet: Vërehet një staf i kualifikuar dhe me eksperiencë në menaxhimin e patologjisë.

Fjalë kyce: eklampsi, mami, menaxhim, njohuri

Diagnostikimi imazherik i patologjive të kolecistës

Dr.Sh.M.Sandër KOLA¹

Prof.Asoc.Irena KOLA²

Msc.Edona Sopaj³

^{1,3}Departamenti i Imazherisë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë

²Shërbimi i Reumatologjisë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë

sander_kola@hotmail.com

irena.kola@hotmail.com

edona_sopaj@hotmail.com

Abstrakt

Hyrje: Kolecistiti akut dhe kolecisti kalkuloz janë patologjitetë më të shpeshta ndër patologjitetë e kolecistës. Metodat imazherike që përdoren për diagnostikim janë: ultrasonografia, CT; MRI, e rrugeve biliare dhe të heparit. Diagnoza e vendoset dhe nëpërmjet: ekzaminimit klinik, vlerës pothuajse absolute diagnostike (Caroli. J), shenjave klinike, analizave biokimike. Ekografia është një ekzaminim joinvaziv me ndjeshmëri dhe saktësi të lartë. CT abdominale vlerëson të gjitha patologjitetë e kolecistës, (Davies et al 1997, Pramo et al 1999). MRI abdominale është e dobishme në lokalizimin dhe përcaktimin e lezioneve në koleciste dhe në hepar (Tschmnelitsch et al 2000).

Qëllimi i studimit: Diagnostifikimi i pacientëve me kolecistit kalkuloze dhe jo kalkuloz, me echografi abdominale, CT, MRI abdominale.

Objektivat e studimit: Përcaktimi i metodës efektive në diagnostikimin e patologjive të kolecisteve.

Materiali dhe metoda: Studimi është kryer në QSUT “Nënë Tereza”, Tiranë. Periudha: 2017-2019. Janë studiuar 200 raste: 176 femra (87%) dhe 24 meshkuj (13%). Raporti femër-mashkull 9:1. Studim retroprospektiv. Të gjitha rastet i nënshtrohen ekzaminimeve dhe trajtimit: - të dhëna klinike dhe anamnestike, analiza kliniko-biokimike – ekzaminime imazherike. – Trajtim paraoperativ me antibiotikë veçanërisht gjatë gjendjes inflamatore. - Trajtim Kirurgjikal në rastet e kolecisteve kalkuloze.

Analiza e studimit: Bazuar në kriteret klinike, biokimike dhe imazherike rezultuan 2 grupe kolecistesh kalkuloze: rastet akute 65 (35.7%), rastet kronike 85 (69.3%). Të gjitha të dhënat dhe rezultatet janë analizuar dhe paraqitur në tabela dhe grafikë.

Konkluzione: Kolecistiti kalkuloz rritet me moshën. Përafërsisht 50% e pacientëve të marrë në studimin tonë ishin mbi 56 vjeç, kjo lidhet dhe me rritjen e jetëgjatësisë në vendin tonë. Ekzaminimi me ultratinguj i barkut zgjidhet për të ndihmuar në diagnostikimin.

CT dhe MRI, pavarësisht kostos, është një ekzaminim i nevojshëm në rastet e diagnozës së komplikuar dhe diagnozës diferenciale.

Fjalët kyçë: kolecista; echografia, CT; MRI, diagnoza.

Diagnoza me imazhe e hernies diskale (rishikim literature)

Msc.Edona Sopaj¹
Dr.Sh.M.Sandër KOLA²
Prof.Asoc.Irena KOLA³

^{1,2} Departamenti i Imazherisë QSU "Nënë Tereza", Tiranë
³ Shërbimi i Reumatologjisë QSU "Nënë Tereza", Tiranë

sander_kola@hotmail.com
irena.kola@hotmail.com
edona_sopaj@hotmail.com

Abstrakt

Hyrje: Hernia diskale është një patologji e shtyllës kurrizore, e cila vjen si pasojë e dëmtimit të diskut intervertebral. Prolapsi i diskut ndërvertebral shoqërohet me dëmtimin e një ose më shumë nervave spinal. Hernia diskale është më e zakonshme në pjesën cervikale dhe lumbare të shtyllës kurrizore, duke shkaktuar dhimbje në rajonin përkatës, lodhje, parestëzi që përhapet në ekstremitetet e sipërme ose të poshtme, sipas vendit ku ndodh hernia. Ekziston një lidhje midis shkallës së dëmtimit, prolapsit të diskut ndërvertebral dhe metodave të imazherisë diagnostike të cilat janë të rëndësishme në zbulimin e hernies së diskut. Ndryshimet degjenerative të kolonës vertebrale shihen qartë në imazhet radiologjike me anë të MRI dhe CT.

Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë domosdoshmërinë e diagnostikimit me metoda imazherike CT dhe MRI në diagnostikimin e hernies së diskut.

Materiali dhe metoda: Është përdorur literaturë nga 13 botime shkencore të marra nga biblioteka mjekësore PubMed, Wikipedia, eMedicine, botuar nga viti 2015 deri në vitin 2020

Rezultatet: Nga ky rishikim i literaturës është konstatuar se rezultatet më të mira diagnostike imazherike të hernies diskale realizohen nëpërmjet rezonancës magnetike, tomografisë së kompjuterizuar.

Konkluzioni: Imazhet me rezonancë magnetike ofrojnë performancë më të mirë në diagnostikimin e hernies së diskut, si dhe hapin një dritare të madhe drejt sofistikimit të kësaj metode për diagnostikimin sa më të shpejtë të hernies së diskut.

Fjalë kyçë: hernie diskale, diagnozë, tomografi e kompjuterizuar, rezonancë magnetike.

Menaxhimi i osteoartritit të gjurit përmes modalitetave dhe rehabilitimit

Prof. Asoc. Irena KOLA¹
Dr. Sh. M. Sandër KOLA²

¹Shërbimi i Reumatologjisë QSU "Nënë Tereza", Tiranë

²Departamenti i Imazherisë QSU "Nënë Tereza", Tiranë

sander.kola@hotmail.com
irena.kola@hotmail.com

Abstrakt

Hyrje: Osteoartriti është një patologji artikulare degenerative e karakterizuar nga shkatërrimi progresiv i kërcit atrial. Klinikisht manifestohet me dhimbje mekanike e përkeqësuar nga lëvizja, dhe pamundësi funksionale progresive të artikulacionit, ngurtësim, dhe kufizim në lëvizje. Trajtimi është mjekim, terapi fizike rehabilituese dhe kirurgji.

Qëllimi i studimit: Qëllimi i këtij studimi ishte përdorimi dhe efektiviteti i modalitetave të elektroterapisë në trajtimin e gonartrozës primare, në një grup pacientësh me osteoartrit të moderuar të gjurit.

Materiali dhe metoda: Ky studim bazohet në trajtimin e pacientëve me gonartrozë primare, të trajtuar në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza", Tiranë. Të gjithë pacientët me gonartrozë dytësore (aritti reaktiv inflamator; osteoartriti post-traumatik; osteoartriti nga patologji të ndryshme si TBC etj.) u përjashtuan nga studimi. Është një studim i rastësishëm. Studimi është kryer në periudhën Prill 2016 - Prill 2018 dhe është bazuar në një pyetësor. Në studim u përfshinë 120 pacientë. 55 meshkuj dhe 65 femra, me moshë mesatare 62,5 vjeç (Nga 45 vjeç - 80 vjeç).

Analiza e rezultateve: Objektivi kryesor në këtë studim ishte trajtimi i dhimbjes dhe funksionit të kyçit (ROM) të gjurit me anë të elektroterapisë. Parametrat e marrë në studim si: dhimbja subjektive sipas indeksit VAS, përmirësim i ROM artikular janë vlerësuar në fillim të trajtimit, pas 3 muajsh dhe pas 6 muajsh.

Përfundim: Përdorimi i ushtrimeve rehabilituese të kombinuara me elektroterapi na çoi në përfundimin se gonartroza menaxhohej, trajtohej më mirë nga ky trajtim i kombinuar, duke çuar në një reduktim të përdorimit të preparateve AINS.

Fjalë kyçë: Osteoartrit; dhimbje; elektroterapi; ROM; ushtrime rehabilituese.

Efekti i kohes së ndërhyrjes dhe zgjatja e rehabilitimit tek pacientët me frakturna trokanterike dhe të qafës së femurit

Neritan Myderrizi¹
Erenato Bushaj²

¹ Sherbimi i Ortopedise, Spitali Rajonal Durrës

² Sherbimi i Ortopedise, Spitali Rajonal Durrës

nmyderrizi@yahoo.com

Abstrakt

Hyrje: Frakturat e qafës së femurit dhe ato trokanterike janë të shpeshta tek moshat e vjetra të cilat duhet të trajtohen në menyre kirurgjikale. Pavarësisht protokollove standarte të rehabilitimit shumë nga pacientet nuk arrin të rifitojne gjendjen fizike që kane patur para frakture.

Qellimi: Ndërhyrja sa me e shpejtë kirurgjikale dhe fillimi sa me shpejt i rehabilitimit dhe zgjatja e tij në kushte ambulatore është celësi i rezultatit sa më të mirë për trajtimin e këtyre fraktureve

Metoda dhe pacientë: U morën në studim 217 pacientë të operuar me frakturna të qafës së femurit të paraqirur në Spitalin Rajonal të Durrësit gjatë periudhës 2019-2021. U vlerësuan koha e ndërhyrjes kirurgjikale, koha e fillimit të rehabilitimit dhe zgjatja e rehabilitimit edhe në kushte ambulatore, në lidhje me rezultatin final.

Rezultatet: Pacientët e trajtuar në sherbimin e ortopedisë së spitalit rajonal Durres ishin të moshës mesatare 74.31 vjec (65-96), 135 femra (62.2%). 94 (43.3%) frakturna të qafës së femurit dhe 135 (62.2%) frakturna trokanterike. Koha e ndërhyrjes kirurgjikale mesatare nga momenti i thyerjes ishte 36.75 orë (20-98), koha e daljes nga spitali 11ditë (7-21) Harris Hip Score pas 3 muajve rezultoi 84 (69-90) për grupin e operuar brenda 48 orëve dhe 78 (60- 82) për grupin mbi 48 orë, sikurse 88 (72-94) për grupin qe vazhdoi fizioterapinë intensive në kushtet e shtëpisë, në krahasim me atë qe nuk vazhdoi fizioterapinë

Konkluzion: Ndërhyrja sa më e shpejtë kirurgjikale dhe vazhdimi i fizioterapisë edhe mbas daljes nga spitali të pacientëve me frakturna të qafës se femurit dhe trokanterike është tepër i rëndësishëm për ti rikthyer këto pacientë në kushtet e para fraktureve.

Fjale kyce: frakturna trokanterike, frakturna të qafës së femurit, Harris Hip Score

Terapia gjenetike në sëmundjet retinale

Dr. Ledia Balla¹

Dr. Daniela Haxhihyseni²

¹ Oftalmologe Spitali Rajonal Durrës

²Departamenti i Shkencave teknike mjeksore. UAMD

Abstrakt

Hyrje: Terapia gjenetike ka marrë një zhvillim shumë të madh dhe nuk mund të konsiderohet si një perspektivë e largët përsa i përket aplikimit të saj në fushën e Oftalmologjisë. Duke qenë se syri nga ana anatomike, konsiderohet një prej organeve më të përshtatshëm për aplikimin e terapisë gjenetike, pritet që dhe rezultatet të janë të suksesshme. Një pjesë e madhe e studimeve shkencore vazhdojnë ende për sëmundje si AMD, Glaucoma, Neuropatia optike etj, Një sukses i madh në fushën e Oftalmologjisë mbetet zbulimi i voretigene neparvovec-rzyl (Luxturna) dhe aprovimi i saj nga FDA.

Qëllimi: kryesor i këtij rishikimi është të sigurojë një përbledhje sa më të përditësuar dhe sa më të plotë përsa i përket gjendjes aktuale dhe perspektivave të terapisë gjenetike si dhe mundësisë sa më të afërt të aplikimit të saj në sëmundjet retinale të trashëgura.

Metoda: Është analizuar me shumë kujdes një pjesë e madhe e literaturës e studimeve eksperimentale, për të raportuar sa më saktë procedurat e këtyre studimeve, arritjet më relevante të deritanishme si dhe kryesorja përsa i përket të ardhmes së terapisë gjenetike në aplikimin e saj në sëmundjet retinale.

Rezultate: Aktualisht zhvillimet e terapise gjenetike për patologji si retinitis pigmentosa apo LCA (leber's anauroza kongenitale) kanë patur një arritje shumë të madhe duke u finalizuar edhe me një aprovim nga FDA përsa i përket Luxturnes, e para terapi gjenetike okulare. E gjithë literatura e studiuar deri tani, përfshirë edhe studimet e shumta klinike dhe preklinike, tregojnë për një të ardhme të afërt të aplikimet të terapisë gjenetike në praktikat okulistike.

Konkluzione: Sëmundjet retinale të trashëgura konsiderohen patologji invalidizuese që prekin kryesisht moshat e reja. Prej vitesh tashmë i është kushtuar rëndësi e veçantë, me studime të shumta klinike dhe preklinike, një pjesë e të cilave vazhdojnë ende, për të gjetur genet respektive përgjegjëse për sëmundjen. Arritje shumë e madhe ishte gjetja e mutacionit të RPE65, përgjegjëse për retinitis pigmentosa si dhe LCA. Luxturna ishte arritura në fushën e terapisë gjenetike për sëmundjet retinale, me sukses edhe në aplikimin e saj tek pacientë me retinitis pigmentosa apo LCA, duke përmirësuar statusin visual si dhe shikimin nokturn.

Studimet e kryera deri tani jane fokusuar kryesisht në fushën e gjenetikës e cila përbën një të ardhme shumë premtuese përza i përket objektivit terapeutik në sëmundjet retinale. Të gjitha studimet eksperimentale tregojnë dhe ofrojnë një shpresë në zhvillimin dhe kryesisht aplikimin e terapisë gjenetike në praktikën klinike në vitet e ardhshme.

Trajtimi gjithpërfshirës i frakturave të fraxhilitetit të radiusit distal, mundësi për të ulur incidencën e osteoporozës dhe frakturave të tjera me rrezik më të lartë morbiditeti dhe mortaliteti në të moshuarit.

MD. Valbona Iljazi¹
Dr. Neritan Myderrizi²

^{1,2} Spitali Rajonal Durrës,
iljazivalbona@yahoo.com

Abstrakt

Hyrje: Frakurat e radiusit distal nga trauma minimale janë frakurat më të shpeshta të ekstremiteteve të sipërme në moshat e mesme dhë te moshuarit, me një incidencë më të lartë në femrat. Mekanizmi më i shpeshtë është rrëzimi nga lartësia e trupit të personit apo edhe më pak, ndërkohë që pacienti vendos dorën për tu mbrojtur me kycin e dorës në ekstension. Pacientët me fraktura të radiusit distal kanë një incidencë të lartë të osteoporozës dhe një rrezik të rritur për fraktura të tjera. Ka një shoqërim midis frakturave të radiusit distal dhe frakturave të femurit distal më vonë. Këto lloj frakturash janë rezultat i anomalive të metabolizmit kockor dhe ndodhin me herët se ato vertebrale apo te femurit proximal, ndaj ato reflektojne ndryshimet e herëshme kockore dhe dobësine muskulare. Frakurat e radiusit distal ndodhin 15 vite më herët se ato të femurit proximal. Nga studime të ndryshme vec në një përqindje e vogël të pacienteve adultë që pësojne fraktura fraxhiliteti rekomandohet DEXA skan.

Metodologjia: Janë përdorur 2 pyetësorë, një pyetësor për mjekët ortopedë që vlerëson incidencën, moshën, seksin, vlerësimin dhe trajtimin e osteoporozës në pacientët me fraktura të radiusit distal nga trauma mininale. Si edhe një pyetësor për pacientët me fraktura të radiusit distal me trauma minimale, të trajtuar pranë spitalit Rajonal Durrës gjatë periudhës Nëntor 2021-Shkurt 2022. Ky pyetësor bëhet për të evidentuar faktorët e mundshëm të rrezikut për këto fraktura. Nga vlerësimi i pyetësorit të plotësuar nga mjekë ortopedë në Shqipëri, frakurat e radiusit distal nga traumë minimale, janë frakurat më të shpeshta në pacientët e moshës 50-60 vjecare. Pas moshës 70 vjecare, për 42% të mjekeve ortopedë, frakurat e humerusit dhe te femurit proksimal janë më të shpeshta se ato të radiusit distal. Këto lloj frakturash janë më të shpeshta në femrat. 54% e mjekëve ortopedë që plotësuan pyetësorin, rekomandojnë DEXA skan, 90% e tyre rekomandojnë kalcium dhe vitamin D gjatë trajtimit te frakturës. Afersisht 60% e mjekeve ortopedë i referojnë këta paciente tek mjeku reumatolog ose mjeku i familjes, për të vlerësuar dhe trajtuar osteoporozën, 36% e mjekëve ortopedë e trajtojnë osteoporozën.

Nga pyetësori për pacientët me fraktuara të radiusit distal nga trauma minimale, 83 % e pacientëve ishin të moshës 51-70 vjec; 97% ishin paciente femra, 6.5% e këtyre pacientëve kanë anamnezë familjare për frakturna fraxhiliteti; 97 % nuk kanë njohuri mbi osteoporozën, vetëm 3 % e këtyre pacientëve kanë nivel edukimi universitar, 73 % e pacienteve nuk referojnë probleme sociale-konomike; rreth 45% e këtyre pacienteve nuk kanë probleme te tjera shendetësore.

Konkluzion: Trajtimi i frakturave të radiusit distal nga trauma minimale paraqet një mundësi për parandalimin e uljes progresive të masës kockore dhe alternimit të strukturës kockore. Pacientët adultë të edukohen mbi rrezikun që kanë për të pësuar frakturna të tjera në të ardhmen dhe ndërhyrjet që duhet të bëjnë për të ulur ketë risk. Mjeku ortoped të rekomandoje DEXA skan për këta paciente dhe të referojë ose trajtojë në menyre adekuate osteoporozën sipas protokolleve standarte, për të ulur rrezikun e frakturave të tjera si ato të vertebrave apo të femurit proximal të cilat janë shkak sëmundshmërie dhe mortaliteti mjaft i lartë.

Fjalë kyce: Frakturë e radiusit distal, osteoporozë, ortoped.

Infermieri, “profesioni i pavarur” edhe në Shqipëri.

MSc. Inf. Fabiola Mane

Abstrakt

Hyrje: Infermieri i pavarur është një profesion që po perhapet më së shumti edhe në vendin tonë. Ky studim bazohet në qytetin e Durrësit, ku kërkesat për infermierë për shërbimin privat në shtëpi u shtuan shumë, sidomos në periudhën pandemike të Covid-19.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë shkallën e kënaqësisë me shërbimin e ofruar si dhekërkësat e pacientëve që i referohen klinikës infermierore.

Materiale dhe metoda: Studimi është i tipit observacional, i shtrirë në periudhën kohore Janar-Prill 2020, dhe janë intervistuar 100 persona. Këta pacientë kanë kërkuar shërbim infermieror në shtëpi pranë qendrave shëndetësore ku banonin. Gjatë asistencës personat janë intervistuar sipas një pyetësori të ndarë në katër kategori sipas moshës, patologjisë, niveli i kënaqësisë ndaj shërbimit, njojhen me klinikën.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë se 55% e të intervistuarve janë pensionistë. Kërkësat për shërbim në shtëpi kanë qenë kryesisht për terapitë Anti-Covid (70%) por edhe patologji të tjera (30%). Shkalla e kënaqësisë është e lartë në të gjitha pjesët e pyetësorit (89%), kjo për të nxjerrë në pah një shërbim të mirë-organizuar, profesional dhe cilësor. Nga prenotimi në klinikë (80%), duke kaluar në llojin e pagesës (40%), infermierja i përgjigjet të gjitha nevojave, jo vetëm të natyrës profesionale, që presin klientët. Njerëzit janë të impresionuar me trajtimin dhe performancën konfidenciale dhe ua rekomandojnë këtë shërbim të njojurve të tyre.

Konkluzione: Infermieri i pavarur është shumë i kërkuar sepse i përgjigjet nevojave shëndetësore mbizotëruese të popullatës. Klinika infermieristike është pranë qytetarit dhe shërbimet ofrohen edhe në shtëpi. Çdo ditë e më shumë, figura e infermierit shihet si një pikë referimi, ku pacientët përpinqen të ndërlidhen sa më shumë me të. Kam besimin se në vitet e ardhshme do të pritet një rritje e profilit të infermierit edhe në Shqipëri, tashmë si një profesion i pavarur pa lënë mbrapa formimin e vazhdueshëm të tij.

Formimi në vazhdimësi i profesionit të infermierit dhe roli i tij në tregun e gjerë të punësimit.

MSc. Inf. Fabiola Mane

Abstrakt

Hyrje: Sektori i shëndetësisë në Shqipëri është një nga sektorët më të rëndësishëm dhe i shpallur vazhdimisht si prioritet për zhvillimin e vendit tonë. Infermieri është një figurë e rëndësishme ekëtij sistemi, evolucioni që ka prekur profesionin e infermierit ka çuar në ndryshime të thella në arsimin dhe praktikën profesionale, duke ndihmuar në konsolidimin e identitetit profesional të infermierit, i cili tashmë është bërë pjesë e “profesioneve intelektuale”.

Qëllimi: Studimi synon të hedhë dritë mbi situatën aktuale të Infermierëve, edukimin e vazhdueshem të tij, në mënyrë që të rritet produktiviteti dhe efikasiteti i Sistemit Shëndetësor në cilësinë e shërbimit.

Materiale dhe metoda: Për të arritur objektivat e përcaktuara u krye një studim observues trasversal në Spitalin e Përgjithshëm Shtetëror të Durrësit. U intervistuan 40 kordinatorë infermieror në periudhën 2016-2018, të cilët e njohin dinamikën spitalore si dhe formimin e infermierëve në repartet përkatëse, duke mbledhur fillimisht informacion në lidhje me veçoritë e punës, më pas duke identifikuar disa karakteristika të realitetit në të cilin ata janë futur, duke vënë theksin në shkallëne kënaqësisë dhe zhgënjamit ndaj sistemit.

Rezultatet: Të dhënrat e mbledhura çojnë në identifikimin e një profili mesatar të infermierit, në një kontekst mjaft kompleks spitalor në të cilin ai aspiron për një trajnim më të gjerë dhe më të përditësuar (38%), veçanërisht për çështjet menaxheriale (29%), për udhëheqjen, për menaxhimine konflikteve (16%) për kërkimin shkencor, pa anashkaluar çështjet klinike – mirëqenëse (9%).

Konkluzione: Trajnim i vazhdueshëm i personelit shëndetësor do të bëjë të mundur nxitjen e ndryshimit në sjellje dhe rritjen e cilësisë së kujdesit në kohë, por edhe për të rritur dhe zhvilluar mirëqenien fizike dhe psikologjike të infermierëve si dhe duke rritur mundësitet e tyre të punësimit në rajon emë gjerë.

Rheumatoid arthritis and pain management (literature review)

Dr.Evis Skuqi¹

Dr. Sandër Kola²

Prof. Assoc. Irena Kola³

¹*Rheumatology Service, Elbasan*

²*Imaging Department QSU "Mother Teresa" Tirana*

³*Rheumatology Service QSU "Mother Teresa", Tirana*

evisskuqi@yahoo.com

irena.kola@hotmail.com

sander_kola@hotmail.com

Abstract

Background: Rheumatoid arthritis (RA) is a chronic, immune-mediated, systemic inflammatory disease of the synovial joints that influences approximately 0.5-1% of the population global. Degrees of RA vary in different patients and are assessed according to intensity, pain, and disability in daily life.

Purpose: The purpose of this literature review is to review RA pain, and mediators primarily cytokines, inflammation mediators, and various RA mechanisms.

Method: This is a descriptive review. Relevant literature was identified by searching PubMed using key search terms, including arthritis, cytokines, cytokine signaling, inflammation, Janus kinases, pain, mechanisms, rheumatoid arthritis.

Results: Several cytokines that target the treatment of RA, such as TNF- α , IL-1, and IL-6, have been well characterized in the pathogenesis of RA and associated pain through autoimmunity promotion, chronic inflammatory synovitis, and destruction of adjacent joint tissue. The range of epigenetic and other mechanisms by which such variants could disrupt cytokine homeostasis to increase disease risk is only beginning to be understood, along with the recognition that in relevant disease contexts they are best dissected at the cellular level. Another descriptive review talks about the role of the central nervous system. Many studies have explored the mechanisms of CNS pain in fibromyalgia and research on CNS pain mechanisms in osteoarthritis is growing.

Conclusions: We conclude that there are different pathways to explain pain in rheumatoid arthritis.

Keywords: pain, rheumatoid arthritis, literature review, patients,

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Universiteti "Aleksandër Moisiu"

ICPS professional studies and labor market : 3rd international
scientific conference : Durrës, april 15-16, 2022 : abstract book /
Universiteti "Aleksandër Moisiu". - Durrës : Zane & AL, 2022

144 f. ; 17.5 x 25 cm.

ISBN 978-9928-4714-4-4

1.Shkenca 2.Teknologjia 3.Konferenca

6 (062)